



# NISEMI! PËR NË HANOI

HASAN M. PETRELA

891.983-94

5

P 55

HASAN M. PETRELA

# NISEMI

## PËR NË HANOI

21242

~~21242~~  
~~10/12/22~~  
446188

BIBLIOTEKA E SHTËPËS  
GJEROMASTËR

SHTËPIA BOTONJESE «NAIM FRASHËRI»

2  
AVSAN M. PRTKLLA

235

NISEMI

PER NË HANOI

SHTRI  
SHTYP  
NISHEMI

SHTYP

THE JANUARY  
1968

Tirazhi 5000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISh Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1968

«МИХАЛ ДУРИ» ЗДИМОТОВО АДРЕСА

16 tetor:

Aeroplani ynë i afrohet aerodromit të Hanoi. Ja tek duken dritat e pistës dhe, në sfondin e errët, toka vietnameze. Neve na pushton një ndjenjë e thellë emocioni. Po vijmë te ti, o tokë e lashtë dhe e begatshme, o tokë e spërkatur me gjak dhe e zhuritur nga predhat dhe napalmi amerikan! Ti je sot poema më madhështore, dhe njërejzit e tu janë heronjtë më të lavdishëm të kohës sonë.

Nata është e butë dhe e ngrohtë. Qielli është i errët dhe me re të dendura. Një aromë e këndshme bredh rrëth e qark nëpër errësirë. Kjo është aroma e tropikut fantastik. Ora është 20,30 minuta. Pioneerët na dhurojnë buqeta me lule të freskëta, të mbledhura në fushat tropikale, kurse shokët vietnamezë na shtërngojnë duart me dashuri. Në mes tyre është edhe nënresidenti i bashkimeve profesionale të Vietnamit, një burrë shpatullgjerë, me një vështrim të imprehtë e të shkathët dhe me ballin pak të rrudhur.

— Delegacioni juaj — na tha ai ndër të tjera tek po pinim çaj — ka ardhur në vendin tonë në një kohë kur lufta e popullit vietnamez ka hyrë në një fazë të re, vendimtare. Imperialistët amerikanë i kanë shtuar në kulm bombardimet e tyre,

por populli ynë po u jep grushte të rënda, si në Veri ashtu dhe në Jugë.

Fytyra e tij shprehte qartë vetitë e të gjithë vietnamezëve: burrerinë, guximin, besimin e plotë në fitore!..

Nisemi për në Hanoi. Ja disa kamionë me të rinj! *Këngë dhe hare*. Bota është e tyre, ata i bien anembanë tokës së tyre mëmë. Pak më tutje është një varg njerëzish me bicikleta; ca me helmeta në kokë dhe me automatikë në sup, ca me kapela bambuje dhe me pushkën varur në qafë. Ky është një aspekt lufte, por në çdo hap që bëjmë, ne shohim dëshirën për të jetuar, e cila nuk vdes kurrë. Mua më duket sikur toka vietnameze mban erë barut, kurse gërmadhat e ndërtesave të bombarduara anës rrugës ku kalojmë më ngjallin një dhimbje të thellë në zemër.

— Ju — më thotë shoku vietnamez që është në maqinë me mua — do t'i shihni më qartë krimet e imperialistëve amerikanë.

Pasi kaluam urën e madhe të Hanoit mbi Lumin e Kuq, pamë dritat e forta të saldatriceve që ngjisnin copra hekurash dhe pas pak u futëm brenda në qytet. Hanoi kish një gjallëri të çuditshme: ai shkëlqente i téri nga dritat elektrike! I zoti i shtëpisë i shuan dritat kur t'i teket, mendova me vete.

Na vendosën në një vilë dykatshe. Një palmë e madhe ngrihet në oborrin e ngushtë, e të rrethuar me kangjella të gjelbërtë hekuri. Në dhomë secili nga ne ka helmetën e tij ushtarake për ta vënë në rast bombardimi. Pasi biseduam një copë herë me njëri-tjetrin, vendosëm të fle-

më. Rruga e gjatë me aeroplan për në këtë vend të largët, mik e vëlla, na kishte lodhur mjaft. Dëgjuam dhe pamë shumë gjëra, por nesër do t'i njohim ato më me hollësi, dhe do të dimë biografitë e emrat dhe karakteristikat e tyre të veçanta...

17 tetor:

Sot delegacionin tonë e priti presidenti i bashkimeve profesionale të Vietnamit. Ai, pasi na foli me një ndjenjë të ngrohtë për miqësinë luftarake që lidh dy popujt e dy partitë tona, bëri një përbledhje të shkurtër të karakteristikave të luftës në Vietnam. Pastaj ai tregoi mbi rolin që luan klasa punëtore në Veri dhe në Jugë, në luftë kundër agresorëve amerikanë për shpëtimin e atdheut. Ky ishte një burrë me trup mesatar, me flokë të rëna dhe me një të folur të lezetshme që të bënte për vete. Ai fliste i qetë dhe fjalët e tij të matura i shoqëronte me gjeste që i shkonin shumë pamjes së tij fisnike. Ai na tregoi hollësi mbi zhvillimin e prodhimit industrial e bujqësor në kushtet e luftës, mbi evakuimet e popullsisë, të uzinave dhe të fabrikave, dhe mbi fitoret e arritura kundër agresorëve amerikanë. Parulla e punonjësve vietnamezë, është: «Kur amerikanët na prishin një urë, ne ndërtojmë dy». «Amerikanët — vijoi ai — po pësojnë disfatë të turpshme në Vietnam. Politika e tyre «luftë në Jugë dhe bombardime në Veri», është dritëshkurtër dhe e falimentuar. Amerikanët përdorin në Vietnam 75%

të ushtrisë tokësore, 60% të forcave ajrore dhe 40% të forcave detare. Ideja e Uollstritit është të pushtohet Vietnamit i Veriut. Por kjo është një ëndërr fantastike. Ne jemi pregetitur shumë mirë. Amerikanët bënин lloj lloj zhurme për periudhën e thatësirave, mirëpo ka më se një muaj që në vendin tonë ka filluar thatësira dhe amerikanët po heshtin. Përse vallë? Sepse ata e ndjejnë që janë të mundur përfundimisht nga populli vietnamez, dhe janë në difensivë, në tërheqje dhe në panik. Së shpejti ata i pret një Dien Bien Fu e re, më e tmerrshme dhe më katastrofalja se ajo e franezëve...»

Biseda ishte e këndshme dhe e gjallë. Ne i thamë atij se populli ynë, që nga brigjet e largëta të Adriatikut ndjek me simpatinë më të madhe luftën heroike të popullit vietnamez dhe fitoret e tij i quan fitore të veta.

— Qëndrimin e popullit shqiptar dhe të Partisë së Punës së Shqipërisë — ndërhyri ai — populli dhe partia jonë e kanë shumë të qartë dhe ne krenohemi që kemi shok armësh një popull trim e një parti trime, siç është populli dhe partia juaj. Ndihma pa rezerva e popullit shqiptar është një fryshtësim shumë i madh për luftën e popullit tonë...

Pas këtij takimi ne vajtëm për një vizitë në ambasadën tonë në Hanoi. Është gëzim i madh kur takohesh në vend të huaj me vëllezërit dhe motrat shqiptare. Të duket sikur ke vite të tëra që je njobur me ta, sikur ua di emrat dhe bisedon me përzemërsi edhe për gjërat më intime. Gratë

e guximshme të ambasadës sonë na kënaqën me tregimet e tyre të pafund.

Amerikanët kishin më se një muaj që s'bombardonin brenda në Hanoi, por vërtiteshin si ujqër të tërbuar në periferitë e tij, ku hidhnin çdo ditë mijëra e mijëra bomba të kalibrave të ndryshëm. Ishim duke pirë nga një kafe dhe duke dëgjuar bisedat e tyre, kur ja, buçitën sirenat e forta të alarmit dhe në çast filloj gjëmimi i artilerisë kundërajrore. Dolëm në oborr. Në qiellin e kaltër dukeshin shtëllungat e tymit të predhave të artilerisë. U dëgjua edhe një zhurmë aeroplanësh. Nëpër rrugë vrapojnë milicianët popullorë — këto batalione të çelnikta të popullit vietnamez — dhe pa humbur kohë zënë pozicionet e luftës. Kalimtarët futen nëpër strehimet personale, që janë me bollëk anës rrugëve. Personeli i një ambasade të një vendi revisionist, duke vrapuar i lebetitur, me një shpejtësi të çuditshme, futet në strehim. Ç'skenë qesharake! Sikur ata të marrin pjesë në ndonjë garë vrapimi, besoj se do të delnin të nderuar, aq shumë ishin stërvitur për vrapime në Hanoi!..

Aviacioni amerikan filloj të bombardonte. Gjëmimë të llahtarshme. Toka dridhet, kurse qielli ulërin nga buçitja e artilerisë kundërajrore. Piratët amerikanë s'gjejnë vrimë ku të futen. Në çdo pëllëmbë, në çdo hap që ata bëjnë, i ndjek predha hak-marrëse dhe plumbi i nënës vietnameze, që është shtrirë barkas dhe tërheq me vertik këmbëzën e automatikut. Më vjen të thërras me zë të lartë: O nënë e dashur vietnameze, o syshqiponjë, o zemëroqean dhe heroinë! Ti mbron lirinë dhe jetën

e bijve të tu! Ti je e pathyeshme! Vrasësit amerikanë të ajrit janë fundërina, gangsterë dhe fluska të qelbura përpara shpirtit tënd të madh!...

Tabloja është me të vërtetë e madhërishme! Deri dje këta njerëz ishin të qetë, të urtë dhe nuk trazonin njeri, kurse sot janë shtrirë mu në mes të sheshit të kryeqytetit të vet, për të goditur me plumb bishat amerikane të ajrit, që vijnë të vrasin fëmijët dhe të djegin fabrikat, shtëpitë, centralet elektrike dhe të shkatërrojnë depot e ujtit.

Beteja vazhdoi disa minuta. Piratët amerikanë ikën si një bollë e rrahur keqas me dajak. Njerëzit dalin nga strehimet dhe kthehen në punën e tyre. Për një çast të duket sikur s'ka ndodhur asgjë me rëndësi. Fytyrat e njerëzve janë të qeta, plot shpresë e lumturi. Jo, fantazma e pangirë imperialiste nuk e mposht dot gazin triumfues të jetës vietnameze!..

Kur u kthyem në banesën tonë, shokët vietnamezë na treguan se ishin rrëzuar pesë aeroplanë amerikanë. Atë ditë, numri i aeroplanëve të rrëzuar, në provincën Than Hua arriti në dymijë e katërqind. Numrin 2400 e plotësoi toga e pleqve. Anëtari më i vjetër në moshë i kësaj toge ishte 69 vjeç, kurse më i riu 49 vjeç. E bënë fora pleqtë e Than Huasë. Radio Hanoi po flet për heroizmin e tyre. Ata me karabina të thjeshta e rrokullisën kuçedrën amerikane. Sa çaste të këndshme do të kenë kaluar pleqtë e asaj toge kur kanë vajtur te aeroplani i gremisur në orizoret! Sa shakara të bukura do të kenë bërë këta gjyshër vietnamezë! Mbështetje edhe u ka lindur ndonjë «kontra-

diktë» e vogël, për të përcaktuar konkretisht njëriun që e goditi i pari piratin amerikan, por...

Dielli, i kuq si trëndafili, perëndoi. Palmën e madhe, të gjatë dhe të bukur të oborrit tonë po e pështjell dalngadalë muzgu i mbrëmjes. Nata e tropikut, e butë dhe e qetë, po zbret me shpejtësi nga xhunglat dhe kënëtë. Eja, natë, eja, ti je si një ditë plot me diell për njerëzit e tu...

### 18 tetor:

Sot u ngritëm me natë. Do të shkojmë për të parë qytetin e bombarduar nga avionët amerikan. Marrim helmetat në dorë dhe nisemi.

Hanoi, edhe në orët e vona të natës, është plot gjallëri. Polici i trafikut qëndron në udhë-kryq për të orientuar kalimin e automjeteve. Dy-qanet janë plot me blerës — gra, fëmijë, të rinj e pleq, — tramvajet lëshojnë fishkullima të zgjatura, ndërsa grupet e karpentierëve pastrojnë ndërtesat e bombarduara, për të rindërtuar atë çka shkatërruan barbarët amerikanë.

Frymëzime e pak e ftohtë. Në Hanoi zakonisht, ditën, kur dielli i tropikut lëshon në tokë rezet e tij të nxehtha, është vështirë ta mbash xhaketën, kurse natën edhe në agim, ajri është i lagët dhe pak i ftohtë.

Hanoi ndahet në pesë rajone të mëdha dhe që të gjithë janë bombarduar nga amerikanët. Arritëm në rajonin Hua Tjen. Zbresim nga matinat, dhe shohim para nesh grumbuj ndërtesash

të shkatërruara. Elektriku i dorës nxjerr në pah vendet ku ranë bombat dhe raketat amerikane. Shumë bomba dhe raketa kanë hedhur xhelatët amerikanë. Ja dhoma e shkatërruar, ku një grua vietnameze kishte qënë duke lindur foshnjën. Një djalë tre vjeç ka mbetur në gjunjë bri shtratit të s'ëmës dhe ka zgjatur duart drejt nënës që kërkonte ta zbukuronte jetën me një krijesë të re. Por përbindshi, që mban emërin famëkeq USA, solli vdekjen e pamëshirshme për nënën dhe për të dy foshnjat. Duke kujtar atë nënë, syri qan, zemra më pikon dhe kredhem në mendime. Ti vdiqe, motër, tok me dy filizat e tu, vdiqe gjithë nur me thesarin e pafund të ëndërrave të tua triumfuse, ti vdiqe, për të mos u harruar kurrë! .

Dhe vagabondët kanë paturpësinë të gënjejnë se gjoja s'bombardojnë brenda në qytet! Por faktet hedhin poshtë gënjeshtrat e tyre. C'janë këto gërmadha në mes të Hanoit? Ja më tutje një faltore e rrrenuar krejtësisht, ja edhe 38 shtëpi të tjera të rrafshuara nga bombat dhe nga raketat amerikane. Ja edhe një spital mu në qendër, i kthyer në shkretëtirë. Mos i mbiftë fara imperializmit amerikan, kësaj pjelle të mallkuar të kohës sonë!

Mbi gërmadhat e një shkolle ku gjetën vdekjen tetë arësimtarë dhe shumë shkollarë të vegjël, ishte vendosur një. parrullë kuptimplotë me figurën e një vietnamezi të revoltuar. Në të shkruhej: «POPULLI DHE USHTRIA DO TË BËJNË QË IMPERIALISTËT AMERIKANË T'I PAGUAJNË SHTRENJTË KRIMET E TYRE».

Sa e sa ndërtesa kanë shkatërruar imperialishtet amerikanë! Atje ne pamë farmaci, dhe shkolla të tjera që ishin bërë shkrumb e hi. Të cfilitet zemra kur sheh pamje të tilla! Më duket sikur nëpërmjet agimit të bukur që po zbardhëllon shoh grushtin e çelniktë, të njomur me lot nënash dhe me gjak fëmijësh vietnamezë, të bjerë vdekjeprurës mbi bishën e tërbuar amerikane. Po, unë e ndjej se ky grusht vigan po vjen me furi nga gurra e madhe e jetës vietnameze. Ai është një-milion herë më i fortë se të gjitha bombat amerikane të marrura së bashku. Ai është grushti i hakmarrjes së madhe popullore, që do të lajë me gjak shpirtin katran të imperializmit amerikan!.

19 tetor:

Përpara nesh qëndron një burrë i shkurtër me një fytyrë të këndshme, që e tregon më të ri. Ai është rrëth 60 vjeç, dhe ka veshur një kostum të pastërt ngjyrë veje.

Ky është kryetari i komisionit shtetëror për hetimin e krimeve të imperializmit amerikan. Pamja e tij të imponon respekt. Në zyrën e tij, që ndriçohej nga drita që depërtonte nga ca dritarë të mëdha, janë raftet plot me dosje, me shkresa dhe me formularë, që përbajnë aktaku-zën më të rëndë kundër krimeve të imperializmit amerikan.

Ai na tha:

«Së pari, dua t'ju shpreh mirënjojen në emër të komisionit tonë, për vizitën që po bëni

në këto ditë të stuhishme në atdheun tonë. Ju na sollët në Vietnam miqësinë e popullit shqiptar dhe pjesën më të madhe të kohës po e kalloni duke parë krimet e imperializmit amerikan. Ne e falënderojmë nga zemra popullin shqiptar, Partinë e Punës së Shqipërisë dhe shokun Enver Hoxha, për mbështetjen dhe për përkrahjen e fuqishme që i japid luftës sonë të drejtë. Komisioni ynë u krijua në vitin 1966 me qëllim që të hetohen, të regjistrohen dhe të demaskohen përpara popullit vietnamez dhe opinionit publik ndërkombetar të gjitha krimet e përbindshme të imperializmit amerikan. Ne synojmë që të shtohet sa më tepër urrejtja dhe forca goditëse e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë, të izolihet ai në arenën ndërkombebare dhe të shtohet solidariteti i popujve të mbarë botës për Vietnamin. Komisioni ynë punon më shumë për t'ua bërë të qartë popujve e sidomos atyre të perëndimit se ç'është imperializmi amerikan, sepse atje ka shumë njerëz që nuk e kanë plotësisht të qartë se agresori është imperializmi amerikan dhe se ai ka bërë krimë të rënda kundër popullit vietnamez. Ne, veitnamezët, u themi këtyre njerëzve: Si nuk e dinë ende ju se ç'është imperializmi amerikan? Ç'farë ju ka trullo sur që të mos dalloni të bardhën nga e zeza? Mprehni vigjilencën, sepse ajo që po i ndodh sot Vietnamit, do t'ju ndodhë edhe juve nesër dhe çdo pakujdesi, çdo nënvleftësim për agresorët amerikanë, do të jetë e hidhur përfatet e kombeve dhe të popujve të vendeve tuaja. A nuk janë bindës këta njëzet vjetët e fundit, gjatë të cilëve imperializmi amerikan po lufton të bëhet sundimtari i botës?

Për këtë qëllim ata kanë hartuar strategjinë globale dhe e kanë ndarë botën në rajone e zona për t'i kolonizuar. Vietnami zë një vend më rendësi në planet e Azisë Juglindore, sepse ai është një vend i pasur dhe imperializmit amerikan i kullojnë jargët për ta patur në dorën e tij. Amerikanët mendojnë se duke pushtuar Vietnamin, këtë vend që qëndron në vijën e parë të luftës kundër imperializmit, do të trembin e do të kërcënojnë popujt e Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Udhëheqësit amerikanë kanë deklaruar shpesh herë se po humbën Vietnamin, do të humbin gjithë Azinë Juglindore, dhe kështu do të humbin të gjitha bazat dhe kolonitë e tjera. Amerikanët pretendojnë se gjoja janë «racë e lartë dhe e kulturuar», mirëpo realiteti tregon të kundërtën. Kush vret dhe merr nëpër këmbë dinjitetin e zezakëve të SHBA? Në Filipinet, në Republikën Domenikane, në Kongo etj. etj. imperialistët amerikanë kanë shfarosur miliona njërez. Ata e përdorën Japoninë si fushë eksperimentale për bombat atomike, kurse tani i janë vërsulur atdheut dhe popullit tonë. Imperialistët amerikanë e kanë quajtur tokën vietnameze poligon qitjeje për të provuar forcën dhe armët e tyre. Por populli ynë di të luftojë dhe të mbrojë lirinë e pamvarësinë e tij.

Duke mos ju trembur vuajtjeve dhe sakrifi-cave më të mëdha, vietnamezët mbrojnë me gjoksin e tyre çdo pëllëmbë tokë dhe po u shkaktojnë agresorëve amerikanë disfata pas disfatash. Megjithkëtë kokëfortësia amerikane arrin deri atje sa ata i mohojnë disfatat e tyre dhe vazhdojnë

të vrasin njerëzit, shkatërrojnë ndërtesat e banimit, urat, fabrikat dhe plantacionet e mbjella me oriz. Këtë gjë ata e bëjnë ditë e natë me tërbim dhe në mënyrën më barbare. Imperializmi amerikan ka zgjedhur rrugën e vrasjes për t'u rrëmbyer popujve lirinë. Ne e kemi akuzuar dhe e akuzojmë imperializmin amerikan, që me agresion merr nëpër këmbë të drejtën nationale, territoriale dhe të vetëvendosjes së popullit vietnamez. E akuzojmë për prishjen e paqës, për krimet e shëmtuara ushtarake dhe për politikën e shfarrës së asgjësimit të kombit tonë. Më lejoni t'ju tregoj tanë etapat e agresionit të imperializmit amerikan në Vietnam. Ju e dini se imperialistët amerikanë, qysh në vitin 1941, kishin hartuar plane për të zëvendësuar kolonizatorët francezë në Vietnam, mirëpo ky plan dështoi. Në vitin 1945, pas shpartallimit të fashizmit, populli vietnamez, në saje të luftës kundër militaristëve japonezë arriti fitore të shkëlqyera. Atëherë imperialistët amerikanë hynë në bisedime me francezët dhe me anglezët për ta ndarë Vietnamin në tri zona, dhe fill pas kësaj amerikanët dërguan trupa gjoja për të çarmatosur japonezët. Ata kërkuan takim me udhëheqësit e partisë e të qeverisë sonë për të bërë pazarllëqe dhe kërcënime, por qeveria jonë refuzoi të bisedojë me ta. Kjo ndodhi në tetor të vitit 1945. Por francezët sulmuan përsëri Indokininët në vitin 1946 dhe krijuan një qeveri kukull. Atëherë partia jonë dha kushtrimin për luftë dhe ne luftuam nëntë vjet me radhë kundër francezëve, por amerikanët, me marifet, po ua merrnin francezëve drejtimin e luftës. Beteja e Dien Bien

Fusë ishte një fakt grusht i rëndë jo vetëm kundër francezëve, por edhe kundër amerikanëve. Kjo ishte etapa e parë. E dyta ndodhi në vitet 1954-1956, kur imperialistët amerikanë shkellën marrëveshjet e Gjenevës. Në këtë etapë, ata ndërmorën shumë veprime për ta kolonizuar Vietnamin. Ata organizuan qeverinë kukull, ushtrinë dhe policinë kukull, krijuan një sistem të tërë me këshilltarë amerikanë dhe ndërtuan me shpejtësi shumë baza ajrore, detare e tokësore, për të push-tuar të gjithë Vietnamin. Në jugë ata po asgjessonin me tërbim të gjithë ata persona që kishin luftuar kundër agresorëve francezë, dhe në këto kushte vëllezërit tanë filluan luftën e rezisten-cës. Popullsia e Jugut korri fitore të shkëlqyera, duke çliruar zona e rajone të tëra. Imperializmi amerikan u tërbua, Filloi etapa e tretë e agresionit (1961-1964).

Imperializmi amerikan në vitin 1961, kishte 3000 ushtarë, kurse në vitin 1964 solli 30.000. Në vitin 1963 qeveria kukull e Ngo Din Diemit pësoi disfatë të madhe. Pas kësaj fillon etapa e katërt e agresionit amerikan (1965-1967). Pas vitit 1965 amerikanët i shtuan shumë trupat e tyre ushtarake. Deri më 16 shtator 1967 ata kishin 439.000 ushtarë dhe 57.000 ushtarë satelitë. Në shkurt të vitit 1965 ata filluan agresionin kundër Veriut kryesisht nëpërmjet forcave ajrore dhe detare. Në fillim aviacioni dhe anijet amerikane bombarduan zonën e çmilitarizuar dhe pastaj gjithë RD të Vietnamit. Ky ishte një agresion i hapur, brutal dhe barbar. Ai synonte të shfaroste popullin viet-

namez. Dhe me patur pësinë më të madhe të thonë se Veriu është agresor kundër Jugut, se gjoja RD e Vietnamit kërcënnon pavarësinë e Amerikës! Kjo logjikë idiote tregon se imperializmi amerikan e quan të ndarë Vietnamin e Veriut nga ai i Jugut dhe se gjoja «amerikanëve u takoka e drejta e ndërhyrjes për të ruajtur statukuonë». Por të gjithë njerëzit përparimtarë e kuptojnë se veprimet e imperializmit amerikan janë në kundërshtim me historinë dhe me ligjet ndërkombëtare. Bile edhe midis amerikanëve ka nga ata që thonë se këto pretdime janë absurde dhe cinike. Por në perëndim ka njerëz që janë trullo sur nga propaganda amerikane dhe thonë se në Vietnam po zhvillohet luftë civile, se amerikanët kanë hyrë, në Jugë në bazë të kërkesave të kukullave dhe se Veriu ka ndërhyrë në Jugë, në bazë të kërkesave të Frontit të Çlirimit të Jugut. Pra, sipas tyre, kemi të bëjmë me dy ndërhyrje. Por ky arësyetim është i gabuar. Faktet tregojnë se imperialistët amerikanë qysh në etapën e parë u përpoqën ta pushtonin të gjithë Vietnamin, por, pasi pësuan disfatë në Jugë, u vërsulën kundër Veriut. Ata po përdorin genocidin kundër popullit vietnamez. Para së gjithash, ata godasin njerëzit dhe çdo gjë që u nevojitet atyre, objektet kulturale dhe qendrat më të populluara, si Hanoin, Hajfongun etj. Po ju sjell një seri faktesh konkrete: qyteti Vin, në provincën Nge An, që ka 72.000 banorë, deri më 30 qershor të vitit 1967 është bombarduar 621 herë, nga të cilat njëqind herë natën, kur njerëzit janë në gjumë. Aeroplanët amerikanë kanë lëshuar mbi këtë qytet 7576 bomba me shumë sfera. TBU qu-

het në Amerikë një lloj bombe që ka formën e ananasit. Një bombë e madhe mëmë shpërndan 600 bomba si ananasi dhe çdo bombë ka 300 plumb ose copa çelniku prej dy milimetra e gjysëm secila. Këto bomba vrasin vetëm njerëzit, sepse ndërtesat i shkatërron bomba mëmë. Ka ca bomba të tjera që peshojnë 1350 kg. Në Luftën e dytë botërore, bomba më e madhe ishte gati 100 kg. 40% e shtëpive të qytetit Vin u shkatërruan. Hajfongu, port i madh detar, deri në fund të shtatorit u bombardua 550 herë. Vetëm në tetëmuajrin e parë të vitit 1967 amerikanët lëshuan 6000 bomba të ndryshme dhe mbi 400 raketa. 400 bomba mëmë përhapën 240,000 bomba të vogla vrasëse, etj. Me datat 11,17, 18 dhe 21 shtator Hajfongu u bombardua 11 herë, u hodhën 425 bomba shkatërruese, 16 bomba mëmë dhe 40 raketa. Në këtë mënyrë avionët amerikanë shkatërruan 600 shtëpi, tri shkolla, tri spitale dhe shumë qendra ekonomike. Nga 30 kryeqendra të provincave që ka Veriu, janë bombarduar 28. Nga 110 lokalitete janë bombarduar 72, prej të cilëve 12 janë kthyer në gërmadhë. Për shembull lokaliteti Ho Ha, me një popullsi prej 5900 banorësh është bombarduar 144 herë, nga të cilat 57 herë natën. Aviacioni amerikan lëshoi mbi këtë lokalitet 22.500 bomba të ndryshme, 10.000 bomba mëmë, 6200 raketa dhe 68 bomba me napalm. Disa shkencëtarë japonezë, që vizituan vendin tonë, thanë: «Ne kemi eksperiencën e hidhur të bombës atomike që hodhën amerikanët në Hiroshima dhe Nagasaki, por mund të themi me bindje të plotë se edhe bombat me napalm të hedhura

21242 21242 21242  
21242 21242 21242

këtu në Vietnam kanë efektuar e bombës atomike.» Përveç qyteteve, amerikanët kanë bombarduar edhe fshatrat. Pjesa më e madhe e periferisë së qyteteve që përmenda më sipër janë bombarduar rëndë dhe nuk ka mbetur asnjë shtëpi dhe asnjë hije peme. Në fshatin shumë të bukur Na Nin, s'gjen dot asnjë hije dhe s'ka pëllëmbë tokë ku të mos kenë rënë bombat amerikane. Deri më 30 qershori janë bombarduar 112 qendra shëndetsore. Në provincën Kuan Bin spitali u bombardua 12 herë, kurse në Ha Tin 17 herë dhe u vranë 139 mjekë e të sëmurë, u plagosën 114 dhe më vonë u vranë 39 vetë dhe u plagosën 40 të tjerë. Amerikanët bombardojnë spitalet dhe qendrat shëndetsore, me qëllim që të mos shërohen dot njërit. Ata bombardojnë digat dhe kanalet vaditëse në periudhën e shirave, kur lumenjtë kanë shumë ujë, sepse shpërthimi i një digë të madhe është mjaft i rrezikshëm. Kështu e ka vlerësuar edhe vetë shtypi amerikan. Kur shpërthen diga e gjithë fusha përblytet dhe, në qoftë se nuk janë marrë masat, mund të mbyten dy-tre milionë njerëz. Veriu ka 26 diga, 17 prej të cilave janë bombarduar. Në kohen e thatësirës ata bombardojnë kanalet vaditëse. Nga 26 kanale të mëdha vaditëse njëzet janë bombarduar rëndë. Deri tani, kanalet vaditëse janë bombarduar 80 herë. E çfarë nuk bëjnë imperialistët amerikanë për të gjunjëzuar popullin vietnamez! Me 14 maj të këtij viti, ata shkuan aq larg, sa bombarduan edhe varrezat e Hanoit.

Ishte ditë peligrinazhi dhe në varrezat kishte shumë gra e fëmijë. Bombat amerikane i vranë

njerëzit dhe nxorën në sipërfaqe koskat e të vdekurve...»

'Befas, ndjeva se m'u rrënqeth i tërë trupi. Kryetari i komisionit vazhdonte të numëronte krimet e imperializmit amerikan, por unë nuk e ndiqja dot më bisedën e tij. Thosha me vete: «Këto që dëgjova unë, dua t'i dëgjojë e gjithë bota...!»

Hakmarrje kërkon populli vietnamez, hakmarrje kërkojnë gjyshërit dhe baballarët e rënë nëpër beteja legjendare, hakmarrje kërkojnë digat që u ngriten me aq mundime, hakmarrje thërrasin kanalet e shkatërruara dhe toka që ujin jetë dhënës pret!...

Po, do të vijë kjo ditë e madhe! Do të vijë, si pranvera e bukur pas shtërngatës. Kjo tokë e shenjtë është krenare, krenar është dhe shpirti vietnamez.

Xhonson, o murtajë e keqe, o mendje e verbër, a nuk e di ti se në tokën vietnameze lulet e varreve nuk mbijnë kurrë? Këtu çdo gjë jeton!

## 20 tetor:

Lufta kalit njerinë. Ky është një ligj i njuhur dhe i vjetër sa bota vetë. Vietnamesezët dhe shqiptarët kanë luftuar me shekuj kundër push-tuesve dhe me gjakun e vet kanë fituar gjithshka. Për këtë flet edhe lufta në Vietnam. Dhe s'ka gjë më të mirë e më të çmuar. Që të ruhet liria dhe pavarësia, nderi dhe dinjiteti kombëtar, lypsen sakrifica. A do ta çmonim ne jetën, liri-

në, lulet, livadhet, gurgullimën e ujtit që i zurret nga malet tonë të gjelbra, dashurinë e pastër dhe këngët e bukura të fitores së madhe, pa kaluar nëpër udhët e vuajtjeve, pa derdhur gjak dhe pa ndjerë dhimbje të thellë në krahror? Jo, jo! Prandaj ne jemi krenarë e të pathyeshëm! Prandaj ne jemi dragonj që s'vdesim kurë! Armiqtë tanë gjithmonë i kanë bërë gabim llogaritë dhe gjithmonë janë mundur e do të mundën. Ti, popull vietnamez, ishe ai që me shigjetat dhe harqet e vjetra të stërgjyshërve ië tu u bëre varrin militarizmit japonez dhe imperializmit frances. Ti je ai që sot e ke shtrirë përdhe kuçedrën amerikane dhe po ja merr shpirtin...

Po udhëtojmë drejt arave dhe orizoreve të një kooperative bujqësore. Maqina ecën shpejt. Një pirg i madh prej dhei ndante më dysh plantacionet e mbjella me oriz. Mbi këtë brez të trashë toke ishin hapur gropat e thella prej nga duken koka njerëzish me helmeta. Zemra na rreh fort. Po shkokemi për të parë milicianët popullore nëpër llogoret e tyre!

Ju afruam llogoreve dhe u futëm në niérën prej tyre, ku pamë tri vajza të reja dhe një djale pranë një mitralozi të rëndë, që me tytën e tij vështronë me rreptësi horizontin e zymtë.

— Jemi në gatishmëri! — na thanë ata me gjuhën e ëmbël vietnameze.

— Bjeruni me tërbim bishave amerikane! — u thamë ne dhe u shtrënguan duart me dashuri.

— Po, po! — u përgjegj me thjeshtësi njëra nga vajzat — kompania jonë ka rrëzuar një aeroplani amerikan.

— Ju lumtë! Ju urojmë suksese të preja!

Vajzave vietnameze u shkëlqejnë sytë. Ato janë të urta, të thjeshta e pak të ndrojtura nga natyra, por kur pirati amerikan futet qfsheturazi, si hajdut, për të djegur të korrat dhe për të shkatërruar kasollet e tyre të qeta, ato vërsulen si tigri mbi të.

— Është gjësim i madh për ne që ju, përfaqësuesit e popullit shqiptar, erdhët sot këtu në llogoret tonë — na tha me emocion komandanti i kompanisë së milicisë popullore. — Ardhja e juaj na frymëzon, prandaj ju lutemi i trasmentoni popullit vëlla shqiptar betimin tonë të madh së ne do ta çojmë luftën deri në fitoren përfundimtare, deri sa të cilohet i gjithë jugu ynë dhe të shporret edhe ushtari i fundit amerikan.

Fjalët e tij na prekën thellë dhe na mallëngjen zemrat.

— Sa mitralozë të rëndë ka kompania juaj?

— pyeti njëri nga ne.

— Tre të rëndë dhe disa të lehtë, përveç pushkëve — tha ai.

— Këta janë të prodhimit kinez — shtoi vajza mitraliere duke buzëqeshur meëmbëlsi.

Po, motër e dashur, Kina dhe Shqipëria ju ndihmojnë me gjithë zemër juve. Atë çast m'u kujtua zhurma e propagandës së revisionistëve për Vietnamin, të cilët mburren se gjoja e ndihmojnë Vietnamin. Por ndihmat e tyre janë si një pikë uji në oqean. Ky vend dhe ky popull s'kanë nevojë për fjalë bombastike dhe për premtimet e rrëme, por duan armë, që të ushtojë qelli cep më cep: nga veriu në jugë, nga lindja në perëndim!

Pas pak doli dielli. Ai dukej madhështor. Rrezet e tij të ngrohta shkëlqenin si kristal. Gjithë fusha, e mbuluar nga mjegulla e lehtë që i qëndronte sipër si tyl, mori një pamje joshëse. E këndshme ishte dhe aroma e mëngjezit që vinte nga palmat dhe nga plantacionet e bananeve. Në Vietnam era e mëngjezit nuk është e ftohtë, por është si një push i butë që të përkëdhel. Më vjen keq që s'kam kohë t'i sodis bukuritë përrallore të natyrës tropikale, të vërej me kujdes ndryshimet e njërsës ditë nga tjera, diellin që si ndonjë kalorës i artë e vështron tokën, gjethet delikate të ananasit dhe lloj-lloj barërash të përkulura, të drejta dhe si shufra të imta çelniku nëpër kaçube.

Kjo tablo zbukurohet edhe më tepër kur shoh kooperativistët duke punuar. Në orizore ka gjësim e hare. Të rejt vietnameze, me shallvaret përveshur deri në gjunjë dhe me kapelet e mëdha në kokë, lëvizin si flutura, duke nxjerrë ujin me kova nga pellgjet e pregititura apostafat dhe duke ederdhur atë nëpër kanalet vaditëse.

U ndamë me luftëtarët trimaditë milicisë popullore. Duke kaluar mespërmes fshatit pamë të mahnitur se si në një kasolle të mbuluar nga fletët e mëdha të palmave, fëmijët e shkollës po bënin mësim. Fëmijët janë të mrekullueshëm si zogjtë. Dhe ata zogj kur na panë u ngritën në këmbë dhe na përshëndetën me cicërimat e tyre të embla. Aty pranë bankove ishin edhe strehimet e tyre.

— Lamtumirë, xhaxhi, lamtumirë! — thanë njëzëri zogjtë e vegjël. Të dridhet zemra kur mendon se në çerdhen e tyre ndonjë ditë mund të bjerë papritur bomba e zezë. Por këta fëmijë po

u ndihmojnë nënave, baballarëve, motrave dhe vëllezërve të tyre, të cilët, ashtu si shqiponja syprehtë, me sqepin e saj çuket gjarpërin e helmatit, po e dërmojnë imperializmin amerikan.

Jemi në shtëpinë e kulturës. Me ne në një nga dhomat e sai është edhe sekretari i organizatës bazë. Ai ndër të tjera na tha: «Dyqind të rinj të kooperativës sonë kanë vajtur në ushtri për të mbrojtur atdheun. Ne nuk trembemi nga shkallëzimi i luftës që bën imperializmi amerikan, nuk derdhim lot për shkatërrimet që mbjellin bombat dhe raketat amerikane, sepse ato s'janë gjë fare përpara së shtrejtës liri dhe pavarësi!»

Në tavolinat tona janë vendosur disa nga prodhimet e kooperativës: banane, hurma, qitro e mandarina. Ne dëgjojmë me kënaqësi nga shokët e kooperativës se, me gjithë vështirësitet e krijuara nga lufta, prodhimi është rritur shumë. Ndërsa në vitin 1964 ata morën mesatarisht rrëth 30 kv. oriz për hektar, në vitin 1966 kjo shifër arriti në 60 kv. për hektar, kurse vjet parashikonin të merrnin mbi 65 kv. për hektar!

Atmosfera u bë edhe më e gjallë, kur një grup vajzash bukuroshe filluan të këndojnë. Këngët vietnameze i përngjasin shumë natyrës së bukur të tropikut. Ato janë të këndshme, melodieze, dhe plot shpresë e lumturi. Ato tregojnë dashurinë për jetën, brengat e shkuara dhe rrezet e arta të së ardhmes. Sikur ta dinte Xhonsoni se tani, në këtë kënd të truallit vietnamez ushton kënga e jetës dhe e gjëzimit, ai do të dridhej nga tërbimi si epileptik. Se mos këndojnë vetëm këtu! Nga i gjithë trualli vietnamez përhapet kë-

ga dhe hymni përvjetën. Ato janë më të fuqishme, dhe oshëtijnë më shumë se gjëma e predhave të xhelatit Xhonson...

21 teter:

Po afron mbrëmja. Ne jemi të emocionuar se do të vizitojmë një rreth trim e heroik.

— Si quhet ky rreth? — më pyet një anëtar i delegacionit tonë.

— S'më kujtohet.

— Vin Fuk — përgjegjet një tjetër.

Vin Fuk... sa emër i bukur!

Nisemi. Rrugët e panjohura të duken gjithnjë më të gjata se ato që njeh prej kohësh. Është natë, hëna s'ka dalë ende dhe qelli plot me yje që cicërrojnë në një lartësi të pakufishme, duket si një hon i thellë, i madh dhe i mistershëm.

Maqinat tona sonte ecin më ngadalë se tjetër herë. Ato, pa drita, çajnë me vështirësi errësirën e natës.

Rrugët gumëzhijnë nga autokolonat e maqinave dhe nga diagaçet zhurmëmëdha, të cilat tërheqin topa dhe raketa.

— Shuaj dritat! — thërresin njerëzit që bëjnë roje anës udhëve, ose pranë urave kur shoferi, përt'u orientuar, ndez një çast dritat e maqinës.

Shuaj dritat! Sa rëndësi kanë këto dy fjalë!

Vietnamezët tanimë kanë fituar një përvojë të madhe në luftën kundër agresorëve amerikanë.

Ata e dijnë se gjarpëri amerikan mund të të vijë befas, të të zbulojë kolonat e maqinave dhe të të kafshojë. Shuaj dritat! Këto fjalë të mësojnë të jesh vigjilent i mprehtë dhe mos e nënveftësosh armikun edhe në çastet më të qeta e më të sigurta. Dhe shoferët heroikë vietnamezë, këta herkulë të vërtetë, binden menjëherë dhe i shuajnë dritat.

— Po natën bombardojnë amerikanët në këto anë? — e pyesim ne shokun Fu, një vietnamez të shkathët, me një kasketë më strehë të gjatë dhe me elektrikun e dorës varur në qafë, të cilin e përdor në raste të rralla.

— Bombardojnë — përgjegjet ai pa e kthyer kokën pas — Amerikanët përpiken të shkatërrojnë komunikacionet tona të fshehta.

Lemë rrugën e asfaltuar dhe futemi nëpër xhungël. Sa udhë të reja, gjarpërushe, ka hapur krahu i fuqishëm vietnamez! Ato rrethohen nga palmat dhe nga drurët shekullorë. Kur kalon nëpër to të duket sikur je në tunel, sepse yjet dhe hapësira e pa fund, nuk duken nga palmat dhe drurët që s'kanë të sosur.

— Këtej do të ketë shumë kobra — i them unë një shoku.

— Patjetër. Një shok, që e ka vizituar Vietnamin përpara gjashtë vjetësh, më tregonte se mafina e tyre i çante më dysh kobrat, të cilat delnin me shumicë nëpër udhët e xhunglave.

— Sikur e ka ekzagjeruar pak ai shoku!

— Të betohem që ashtu më ka thënë.

— Po pse ne s'kemi parë asnje kobër me sy deri më sot?

— Prit — buzëqesh ai — tani po udhëtojmë  
nëpër xhungla.

Vë kokën pas xhamit të maqinës dhe e ngul  
vështrimin tutje. Palmat më ngajnjë si bateri  
kundërajrore, kurse hijet që luhasin, si figura  
njerëzish.

Maqina ndërroi marshin, se filloj e përpjeta.

— Tani dalin kobrat — më tha shoku si për  
të hapur bisedë.

— Me sa di unë, gjarpinjtë flenë natën.

— Kush ta ka thënë?

— E kam lexuar diku.

Maqina u ngjit në një kodrinë. Në të majtë  
disa këneta shkëlqejnë si pllaka të argjenta. Një  
yll u shkëput nga qelli dhe lëshoi në atmosferë  
pluhur kozmik. Ai la pas një brez të shndritshëm  
dhe, pasi u shua, errësira u shtua edhe më shumë.  
Vetëm sytë e ndonjë shpendi të egër mund të  
shohin mirë në një natë të tillë. Mirëpo shpendët  
dhe egërsirat kushedi nga janë zhdukur. Ato ka-  
në ikur thellë e më thellë, sikur e ndjejnë se një  
përbindsh i panjohur për to po i ndjek këmba-  
këmbës!...

Natyra e tropikut filloj të ndryshojë dalngadalë. Përpara nesh duken, si hije gjigante, kon-  
turet e ca maleve të larta. Një erë e ftohtë vër-  
shon me nxitim nëpër dritaret e hapura të xhipsit  
tonë. Për një çast të duket sikur stinët pësuan  
një ndryshim të menjëhershëm: sikur nga pranve-  
ra hymë në vjeshtë.

Mbi një orë ecëm nëpër mal. Xhipsi herë  
ngjitet, herë zbret poshtë. Më në fund zbritëm.  
Vendi ku u ndalëm ishte një pyll i dendur. Dë-

gjojmë një pëshpëritje në gjuhën vietnameze. Çaugjinshi! (tungjatjeta!) — na thanë shokët vietnamezë dhe shtrënguam duart me ta. Një elektrik dore ndizet e shuhet sakaq. Disa vajza na afrohen në errësirë, dhe na dhurojnë tufa me lule. Çaste prekëse. Ne u njohëm me vëllezërit dhe motrat vietnameze në mes të xhunglës, natën dhe pa e parë mirë në sy njëri-tjetrin, u takuam tamam ashtu siç takohen luftëtarët në kushtet e luftës!..

Kasollja ku hymë, ndriçohej nga drita e fortë e një petromaksi. Ulemi rrëth trapezave me mbulesa të pastra të bukura dhe gjithë qëndizma.

— U lodhët? — na pyeti sekretari i komitetit të partisë të provincës Vin Fuk.

— Jo, kemi udhëtuar shumë mirë.

— Ne jemi vëllezër të vërtetë — vazhdoi ai me atë tonin e tij të gjallë. — Ne krenohemi që kemi shokë lufte shqiptarët heroikë. Ju keni një përvojë të mirë në luftën kundër imperializmit dhe reaksionit. Dhe ne po bëjmë një luftë të ashpër kundër imperializmit amerikan. Populli shqiptar dhe PPSH na përkrahin me gjithë shpirt për luftën kundër imperializmit amerikan. Ju keni ardhur përvizitë në provincën tonë, dhe kjo na gëzon pa mësë, por... s'e fshehim dot: kushtet për juve janë shumë të rënda.

— Pse të rënda? — e pyeti kryetari i delegacionit tonë.

— Ja, nëpër pyje, nëpër kasolle, — tha ai, — dhe buzëqeshi plot hirësi.

— Tamam nëpër këto kasolle ne e ndjejmë veten si në shtëpinë tonë.

Tek hanim darkën, ne dëgjonim me kënaqësi

të madhe bisedat interesante që na tregonin shokët e kësaj province. Vin Fuku bombardohej vazhdimisht. Vite më parë ky rrëth ishte shkatërruar në themel edhe nga imperialistët francezë. Por, pas çlirimit, mbi gjërmadhat e tij kishte lindur një Vin Fuk thuajse krejt i ri, i bukur dhe madhëstor. Tani ai përsëri po rrënohej nga aviacioni amerikan. Por përsëri do të rilindë një Vin Fuk i ri, edhe më i bukur e më i ndritur.

— Deri tani provinca jonë — vazhdoi të flasë sekretari — ka rrëzuar 27 aeroplani amerikanë. Ai rrëth që rrëzon njëqind aeroplani, dhe si argument tregon bishtin e tij, fiton flamurin e qeverisë.

— Tamam si fshatarët tanë që dorëzojnë lëkurën e ujkut — tha dikush nga ne.

Biseda rridhte e qetë dhe e butë, si ajri që na rrethonte. Mësuam se ky rrëth nga konsumator që kish qenë më parë, tani i jepte shtetit mbi 55.000 tonelata ndrithëra. Në këto anë fshatarët i punojnë natën tokat e tyre. Për natën tregojnë gjëra të çuditshme. Nëpër përrallat dhe legjendat e popujve ajo është paraqitur si dëshmitari i ngjarjeve më të papritura dhe më të shëmtuara. Pse vallë? Ndoshta ngaqë është e errët dhe misterioze? Apo sepse natën kanë ndodhur gjëra të tillë që kanë krijuar gjeneratë pas gjenerate enigma, dyshime, frikë dhe fiksacione nga më fantastiket? Sidoqoftë, unë e dua dhe e adhuroj natën vietnameze. Errësira e saj shërbën si një mbulesë gjigante për tokën dhe për njerëzit. Natën punohen arat, natën lëvizin autokolonat e pafundme, natën lëvrijnë lcpatat e barkave dhe të maunave, natën ndreqen udhët dhe shinat e hekurudhave, natën vendosen

urat prej bambuje, ose urat e nënujëshme, që lidhin njërin breg të lumi me bregun tjeter, që të kalojnë lirisht njerëzit, maqinat dhe qerret. Të përshëndet ty, o natë vietnameze, e punës dhe e krijimit, o nënë e shpresës dhe e fitores!..

## 22 tetor:

Kur u zgjova në mëngjez, dëshira ime e parë ishte të shihja vendin ku ndodheshim. U ngrita dhe, pasi u vesha shpejt e shpejt, hapa derën e kasolles. Ish një ditë shumë e bukur. Frynte një erë e lehtë dhe e freskët. Dielli ndriçonte për bukuri. Përkundrejt kasolles dukeshin vargje malesh të mrekullueshme, forma e të cilëve ishte mjaft interesante. Kurrë s'kisha parë male të tilla. Bile as që e dija se në vendet tropikale ka male me një lartësi prej 1800 metrash. Këto male ndodheshin në kufi me Laosin. Për disa çaste mbeta si i mahnitur. Sa larg kishim ardhur! Nga këto male vinin për të bombarduar Vin Fukun aeroplanët amerikanë, që ngriheshin nga bazat e tyre të Tailandës.

Kur, i kredhur në mendime, po sillesha rrotull nëpër oborr, më afrohen dy gra. Njëra kish në dorë një libër me poezi lirike. Në bisedë e sipër ajo na tregon se i shoqi i asaj kish vajtur ushtar, kurse ajo punonte në kooperativë. Ndërkakq vemendjen ma tërheq një fëmijë rrëth pesë vjeç, i cili mbante oriz në dy kosha, që i kish varur në drurin e bambusë. Ai ecte duke ju dri-dhur këmbët nga pesha. Në atë çast më erdhi keq për atë vogëlush të vafër. Dhe, duke u dhënë li-

ri të plotë ndjenjave të mia mendoja: sa shumë llomotisin revizionistët sovjetikë dhe gjithë kopeja e tyre se gjoja ndihmojnë Vietnamin! Ç'gjenjeshtra bajate! E përsëris me forcë: ku i keni armët për këtë popull, revizionistë? Ku i keni veshmbathjet dhe ushqimet për këta fëmijë e për këta njerëz të mrekullueshëm, që luftojnë jo vetëm për veten e tyre, por edhe për revolucionin botëror, dhe që meritojnë të kenë gjithshka me bollëk? Të gjithë popujt duhet të heqin nga goja e tyre kafshatën dhe t'ja dërgojnë vietnamezëve të lavdishëm. Mirëpo, Moska, Budapesti, Varshava dhe Praga kridhen në një jetë të shthurur, njerëzit vrapojnë pas lluksit, harbojnë duke u gdhirë nëpër kabaretë pa çarë kokën fare se ka popuj që derdhin gjak dhe që përleshën fyt për fyt me imperializmin amerikan, kurse udhëheqësit e tyre tradhëtarë, bëjnë pazarllëqe me krerët amerikanë për të shuar luftën titanike të popullit vietnamez dhe nga ana tjetër cirren se gjoja ndihmojnë Vietnamin. Oh, ç'maskarenj të paskrupull!

Pas dite vizituam një uzinë të madhe mekanike, repartet e së cilës ishin vendosur në male. Ajo ish bombarduar disa herë nga avioni amrikan, por dëmet kishin qenë të pakta. Atëhere u vendos evakuimi i saj. Tani uzina funksiononte për bukuri. Planet realizoheshin me sukses. Zhurma e maqinave e këndshme dhe gazmore përhapej nëpër luginat e këtyre maleve. Duket sikur edhe mallet qeshin dhe krenohen që u bënë strehë e sigurt për punëtorët e Vin Fukut. Këta punëtorë — djem e vajza të reja — prodrojnë dhe luftojnë. Secili ka pushkën pranë maqinerisë së tij. Edhe strehimet

janë aty brenda nëpër reparte. Banorët e Vin Fukut kanë tradita të shkëlqyera revolucionare. Gjatë luftës antijaponeze edhe antifranceze këto male kanë qenë baza e partizanëve vietnamezë. Kushedi sa herë pësuan disfatë gjeneralët francezë në pëpjekjet e tyre të kota për të pushtuar këto male!...

Pas vizitës, muarëm pjesë në një miting të madh ku kishin ardhur shumë punëtorë e punëtore. Nëpër tavolinat ka buqeta me lule, kurse në mure janë vendosur parulla në gjuhën shqipe kushtuar miqësisë luftarakë që lidh dy popujt tanë. Tavolinat janë vendosur anash, kurse poshtë tyre është hapur një kanal i madh që lidhet me tunelin kryesor, i cili i bie rrotull pothuajse tërë malit. Ç'mençuri e madhe karakterizon vietnamezët!

Fytyrat e gjëzuara të punëtorëve, vështrimet e tyre të ciltëra shprehin krenarinë që midis tyre ndodhen vëllezërit të ardhur nga Shqipëria e largët. Sa i mrekullueshmë është revolucion! Sa e shenjtë është lufta kundër imperializmit, kundër reaksionit dhe revizionizmit!. Ja si çelnikoset miqësia midis popujve revolucionarë! Kjo është një miqësi e vërtetë dhe e pastër, që shtrihet edhe përtej maleve që janë kaq larg nga vendi ynë. Prapa këtyre maleve kemi vëllezërit laosianë, të cilët, si edhe ata vietnamezë, po luftojnë burrërisht kundër imperializmit amerikan dhe veglave të tyre. Më tej kemi partizanët trima të Tailandës. Me ne janë tërë popujt revolucionarë dhe ne jemi kudo, në çdo cep të rrugullit tokësor ku kërcet pushka për liri!

Një shok i delegacionit tonë mbajti një fjalim shumë prekës. Ndërsa ai fliste për solidaritetin ndërkombetar me Vietnamin, duartrokitjet shpërthenin me furi. Më dukej sikur jehonte tërë pylli. Ky solidaritet aktiv duhet të vërshojë si valët e lumenjve të rrëmbyeshëm nga të katër anët e botës. Dhe tek mendoja për këto gjëra, m'u kujtua një episod interesant që më treguan shokët e Vin Fukut. «Një ditë, amerikanët po bombardonin me tërbim. Hodhën shumë bomba. Mirëpo një bombë e madhe mëmë s'kish pëlcitur. Milicianët popullorë nisen ta çmontojnë. Frika se mos bomba do të pëlciste papandehur u zhduk menjëherë, kur brenda saj u gjend një letër. Ç'donte kjo letër brenda në bombë? Ajo mbante këtë shënim: «Bombë e sabotuar. Punëtorët amerikanë janë me ty, Vietnam...»

Mitingu mbaroi dhe në çast qindra zëra ja morën menjëherë këngës kushtuar bashkimit të Vietnamit. Gjithshka rreth nesh shkëlqente me gëzim.

- Shiko sa bukur! — i them unë një shoku.
- Po, bukur — përgjegjet ai me zë të ulët.
- S'ka forcë që ta mposhtë shpirtin e madh të këtij populli.

Kur po largoheshim nga Vin Fuku për në provinca të tjera, shokët e këtij rrethi shprehën keqardhjen e tyre që s'pamë dot një betejë ajrore. Edhe neve, ç'është e vërtetë, na erdhi shumë keq që humbëm një rast të tillë, por fundi i fundit, faji s'ish i yni, por i piratëve amerikanë që s'erdhën...

\* \* \*

Maqinat tonë janë maskuar në mënyrë të çuditshme: me palma, shkurre dhe me lloj-lloj degësh të tjera, që kanë ca fletë të dendura e të imta. Pra po bëjmë një udhëtim edhe më të rrezikshëm.

U nisëm. Lindja ka filluar të skuqet.

— Sonte besoj se do ta shohim hënën — i them shokut.

— Mbështetje. Ne as që e dimë nga del hëna këtej.

Hija e natës po bie dalngadalë. Unë vështroj me vemendje konturet e buta të maleve, shkëmbinjtë e ashpër, fshatrat e bukura me palmat e mëdha, fytyra fshatarësh e fshatarkash të veshura me ato shallvaret prej mëndafshi të zi, ndonjë qerre që e tërheqin buaj të shëndoshë dhe, anash, gropat e hapura për t'u strehuar udhëtarët. Mendoj: Sa gropa të tilla mund të ketë vallë? Oh, ato s'numërohen dot! Por unë di një gjë, që çdo vietnamezi i takojnë mezatarisht tri strehime përfrymë. Kjo shifër është më se e mjaftueshme përtë kuptuar se toka e shenjtë vietnameze ka hapur plagë në çdo pjesë të trupit të vet, për të shpëtuar jetën e bijve të saj.

U err pothuajse fare dhe filloi të përhapet lagështia. Tani ndjehet më fort aroma e tropikut. Në qellin e kaltër, dualën yjet e para.

Udhëtimi po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Kalojmë nëpër udhë krejt të panjohura. Edhe shofëret që i njobin këto vende zbresin ndonjëherë dhe përpiken të dallojnë në se po shkojnë andej nga duhet apo kanë ngatërruar rrugën.

Nëpër prita afër urave dhe vendeve të dyshimta, ku mund të bombardojnë piratët amerikanë, ka përsëri kolona të gjata maqinash, vargje të pafund ushtarësh dhe grupe njerëzish që bëjnë roje. Që andej dëgjohet zhurma e diagaçeve. Befas maqinat qëndruan. Ne s'po kuptojmë gjë. Ndërkaq shoku Fu zbret, ndez elektrikun e dorës dhe ne arrijmë të shohim se aty përpara është një autokolonë.

— Si është puna, shoku Fu? — e pyesim.

— Ura është bombarduar. Duhet të kalojmë nëpër një urë tjetër, të nënüşeshme, zbrisni.

Pasi zbritëm dhe u larguam nga autokolona, ngjitemi në një bregore, ku secili i afrohet grüpës së tij. Një bilbil dëgjohet herë pas here. Ne e dimë që është bilbili i policot, i cili orienton maqinat.

Nata nxin si një lubi. Në terrin e natës xi-xëllonjat. lëshojnë herë-herë shkëndija të vogla, që ndizen e shuhën sakaq. Nga larg dëgjohen zëra shoferësh dhe zhurma maqinash që s'i kanë shuar motorët. Ne qëndrojmë aty në bregoren si gjahtari në korije, shikojmë aty në bregoren, si ai gjahtari rrëth e rrrotull dhe e vërejmë gropën që kemi pranë. Çështë e vërteta, këto lloj pritjesh janë edhe të padurueshme, por ne krenohemi që jemi në gjirin e këtij populli heroik. Çdo pritje, çdo hap që bën, çdo skenë, sado dramatike që të të shfaqet përpara, ta forcon pikërisht bindjen se ky popull është i pathyeshëm!

— Nëpër maqina, shokë — tha dikush. Shoku Fu afrohet drejt nesh dhe me elektrikun e dorës na hap udhën, për të mos u penguar në ndonjë gropë apo hendek.

Rruga është e ngushtë e me gropë dhe makinë herë-herë hidhet përpjetë. Ja konturet e urës së shkatërruar nga aviacioni amerikan. Ajo ngjan si një njeri i plagosur rëndë, por që nuk epet. Kushedi sa njerëz dhe makinë kanë kaluar mbi shpatullat e saj të çelnikta! Bri saj, sikur të jetë pjellë e urës së shkatërruar, u ngrit një urë tjetër, e thjeshtë dhe elastike. Kjo bijë e re e nënës së plagosur i ka shpatullat po aq të forta sa dhe e ëma dhe mban lloj-lloj peshe. Ajo dridhet pak, kur mbi të kalojnë kamionë me rimorkio të ngarkuara plot e përplot, por kjo dridhje nuk është rënkim por është një pëshpëritje kreñare, është kënga e saj hirplotë.

Doli edhe hëna. Ajo është e zbehtë.

— Si kokë luani — më tha një shok tek e shihte ashtu të plotë, në sfondin e errët të maleve të larta e plot kreshta.

Po, si kokë luani është hëna sonte. Ajo vahdon të ngjitet në qielin e zi, si ndonjë balonë e artë, që e tërheq filli i kalamanit. Herë-herë më duket sikur e ka ngulur vështrimin e saj në xhamin e maqinës dhe sikur diçka më pëshpërit. Syri i saj futet tanë nëpër kënetat, nëpër xhunglat dhe nëpër pyjet ku flenë tigrat, kaprojtë, ketrat dhe shpezët e bukur dhe me famë të tropikut. Syrin e saj të bukur e do shtegtarë, ushtari dhe detari në oqean. Nën rrezet e palëvizshme të saj, shkëlqen uji i kënetave, konturet e kodgeve, palmat dhe plantacionet e mbjella me banane, me kafe apo me oriz. Tropiku përhap një aromë të këndshme, sa kraharori më gufon, padashje, gjithnjë e më shumë.

— Tani jemi në territorin e provincës Nam Ha — na thotë shoku Fu.

— Është e madhe kjo provincë?

— Po, ka gati dymilion banorë.

Heshtim. Ndërkaq unë vështroj lumenjtë që lëmë pas, qiellin dhe hënën që tani na rri profil.

— Së shpejti do të kalojmë nëpër qytetin Fu Li. A ju kujtohet emri i këtij qyteti? Për këtë ju foli kryetari i komisionit të hetimeve.

— Aty do të qëndrojmë?

— Jo, Fu Li është bombarduar shumë, shumë rëndë. Ne do të qëndrojmë në periferi të qytetit Nam Bin. Këto vise përgjithësisht janë shumë të bukura. Në lindje të provincës shtrihet oqeani, kurse në veriperëndim janë malet e famshme të Nam Hasë.

Ai flet, por mua një dhimbje e thellë ma pushton kraharorin. Më vjen keq që po e shkel tokën vietnameze pëllëmbë për pëllëmbë dhe s'jam në gjendje të shijoj siç duhet bukuritë e saj.

— Kjo provincë — vijoi shoku Fu — është bombarduar njëmijë e pesëqind herë.

— Ashtu?

— Po. Një sërë qytetesh, veçanërisht Fu Li dhe Nam Bin, janë dëmtuar rëndë.

U dëgjua fishkëllima e një bilbili. Maqina e cte ngadalë duke bërë një kthesë. Atje, në këmbë, e gjatë dhe me një pamje plot krenari qëndronte një vajzë që drejtonte komunikacionin. Ajo m'u duk si një dru pishe që s'e mposht dot asnjë rrebesh. Ajo lëvizte dorën e saj, tek e cila unë shihja dorën gjigante dhe tërë muskuj të çelniktë të popullit vietnamez. Mendoja: Sa mirë

që kudo ka rregull! Po, populli vietnamez i ka marrë në duart e veta fatet e luftës. Ja ç'do të thotë rend socialist. Po të kish qenë ndonjë vend tjetër me rend tjetër, ishte e pamundur të qarkulloje lirisht në orët e vona të natës dhe të mos ndesheshe me grupe vjedhësish dhe me lloj-lloj bandash. Kurse në Vietnam bridh nga të duash: nëpër pyje dhe nëpër male, nëpër udhë të asfaltuara apo nëpër udhët e reja sekrete, por kudo sheh bukurinë e jetës, të qetësisë e të rregullit të përsosur. Atje njerëzit të vështrojnë me sinqeritet dhe me buzëqeshje. Ata janë të gatshëm për të të ndihmuar, po të kesh nevojë...

Ç'janë këto gërmadha? Mos janë të qytetit Fu Li? — pyeti njëri nga ne.

Në atë çast unë u shkëputa nga ëndërrimet.

— Po, Fu Li — murmuriti shoku Fu, duke i shoqëruar fjalët me një pshëritimë të thellë.

Nuk kaloi shumë kohë dhe ne ju afroam gërmadhavë. Maqina ecën fare ngadalë. Shoku Fu ndez elektrikun për të ndriçuar ndërtimesat e rrënuara. Kubetë e shtëpive dhe të fabrikave të bombarduara vareshin mbi brezat e mureve, që, ndonse të shembur, nuk kishin rënë të tërë përdhe. Një ndjenjë e thellë zemërimi mbushi zemrat tonë. Por kur dëgjoj tingujt e muzikës që përhapin altoparlantët nga gërmadhat, sikur përtërihem dhe qortoj vetëveten: mjافت më, hesht! Pjella e shëmtuar e këtyre mënxyrave, do t'i paguajë shumë shtrenjtë krimet e veta! A nuk dëgjon muzikë? Jo, nuk je në ëndërr! Kjo është një muzikë plot optimizëm, kjo është muzika e jetës.

— Sa mirë, shokë, që nga gërmadhat jehon muzikal!

— Po, muzika është personifikimi i jetës.

Nga dritarja e maqinës shikoj grumbujt e errët të fasadave të dërmuara, që duken sikur përpëliten me krahët e thyera e të degëzuara, shikoj tokën e heshtur dhe tërë ato mbeturina tullash, tjegullash dhe hekurash të shtrembüruar, dëgjoj tingujt e muzikës që vinin nga thellësia e qytetit, dhe më duket sikur të gjitha këto i përgjigjen në mënyrë të çuditshme vrullit të fshehtë që shpërthen në zemrën time.

— Lamtumirë, Fu Li i dashur, lamtumirë, ju, o tinguj të ëmbël që në çastet më mallëngjyese më mbushët me lumturi! Lamtumirë, ju, ndërtesa të rrenuara! Tjetër herë unë do t'ju shoh të reja dhe më të bukura nga ç'kini qenë!...

U mbështeta në mbështetësen e butë prej meshini të maqinës dhe ndenja një copë herë duke menduar. Nuk më kujtohet sa kohë udhëtova kështu.

Lagështira e natës më bie në fytyrën e ndezur flakë. Tani jemi futur në një xhungël që duket sikur s'ka mbarim. Besoj që edhe Norman Betyni, nuk ka bërë një udhëtim të tillë, kaq interesant, kur erdhi nga Kanadaja për të marrë pjesë në revolucionin kinez.

Nata është e qetë. Qielli ndrit nga hëna dhe nga yjet e shumta. Konturet e shkurreve dhe të palmave, duken shumë qartë. Ja tek është një kënetë që shtrihet sa gjerë gjatë. Pas pak dëgjuam kërcitjen e rrotave të maqinës që po kallonte mbi një urë prej bambuje. Sa ura të tillë të mrekullueshme ka ndërtuar ky popull vigan! Ditën ato hijen dhe natën vihen përsëri. Mbi këtë urë pothuajse të rrafshët me ujët e kë-

netës, një çift dashnorësh, sodiste pejsazhin fantastik, që shtrihej përpara tyre. Ky çift qëndronte në mes të kënetës dhe dukej sikur të ishte një vepër skulpture. Rreth e rrotull tyre kishte ujë, kurse anash kuçube pemësh, që rriten me bollëk nëpër kënetë. Vajza, shtathedhur, me një shami të bardhë në kokë, diç i pëshpëristë djaloshit. «Ja ç'ështëjeta! — mendoja me vete dhe isha shumë i gjëzuar. — Ndoshta nesër djaloshi do të shkojë ushtar, prandaj sonte po rri me të fejuarën. Bota është e tyre. Këtë jetë që lulëzon, siç lulëzojnë bimët e bukura të tropikut, nuk ka forcë ta ndalë. Në ato çaste m'u kujtua një poemë e Gorkit, ku flitet mbi dashurinë. Në poemën e tij Gorki thotë se një çift dashnorësh as që e përfilli fare mbrettin mburravec që erdhi kaluar pranë tij. Por populli vietnamez e ka zënë për kapistre kalin e mbretit amerikan dhe po e detyron mbretin të zbresë poshtë!»

Aq shumë isha i gjëzuar nga ajo pamje sa s'vura re fare se kishim arritur në vendin e caktuar. Ecja pas shokëve. Gjethet e buta të palmave ma rrini ftyrën. U futëm në kasolle. Shokët vietnamezë e kanë mësuar zakonin tonë dhe na përqafojnë sipas zakonit shqiptar. Kjo na gjëzon pa masë. Ç'njerëz të mrekullueshëm. Sa shumë që na duan!

Kasollja është si një dhomë e madhe dhe e rregulluar shumë mirë: me mobilje, me kolktive të bukura dhe me perde mëndafshi. Ne çuditemi se si në mes të bambuve, të palmave dhe të bananeve ndodhet një kasolle kaq e bukur, që s'do ta ndërroja edhe me hotelin më lluksoz.

Pas një informacioni të shkurtër, ku na folën shokët vietnamezë, ramë për të fjetur. Pranë krevatit të seclit ndodhet edhe gropë e strehimit, për t'u futur brenda, në rast bombardimi.

### 23 tetor:

Gjumi më doli nga cicërimat e ëmbla të shpeshëve.

Afër kasolles sonë një kanerinë ja kishte marrë më nge. Unë e mora me mend se ky vend do të kish një bukuri të rrallë. Dola. Para meje shtrihej një pamje madhështore: palma fletëmëdha të dendura, me një ngjyrë të gjelbër të çelur, banane, kokos dhe lloj-lloj drurësh të tjerë tropikalë, që janë kaq joshës, sa s'ngopesh duke i parë!

Një diell i bukur shkëlqente në horizont. Rrezet e tij të ngrohta e të arta, ndrisnin tokën e veshur me gjelbërim. Ishte koha kur piqeshin bananet. Një erë e lehtë përpëlitez pa pushim nëpër fletët e bambuve, të palmave dhe kokosve. Unë vazhdoja të ecja qetë-qetë nëpër këtë tablo fantastike, por, s'di përsë, zemra më rrihte me vrull. Sa më tej që shkoja, aq më e bukur ishte panorama. Eca edhe pak dhe pashë se në të majtë rridhët qetë-qetë një lumë, ujët e të cilit farfuriante nga rrezet e diellit. Një barkë e vogël, që e ngiste një çunak, lundronte mbi ujin e gjelbër, duke përhapur një kumbim të lehtë e të mbytur. Papritur dëgjoj akordet e një muzike të ëmbël. Siç duket, më vonë do të jepet ndonjë program artistik.

Tek rrija duke soditur natyrën m'u afrua shoku Shii, përkthyesi ynë.

— Të pëlqen pamja? — më pyeti, dhe më zgjati një cigare.

— Shumë — ju përgjegja — Kurrë s'kam parë pamje kaq të bukur.

— Sa më në jugë të shkojmë, aq më e bukur është natyra. 20 kilometra larg nesh shtrihet Oqeani Paqësor, kurse qyteti Nam Bin ndodhet ndërmjet nesh dhe oqeanit.

— Do ta vizitojmë qytetin?

— Nuk e di. Ai bombardohet vazhdimishit nga amerikanët. Brenda tri minutave futen në Nam Bin aeroplani të amerikanë. Ata ngrihen nga aeroplanmbajtëset e flotës së shtatë.

Duke pirë duhan, shoku Shiu buzëqeshi. Ai është një djalë me trup të vogël, me fytyrë të imët. Disa ditë më parë ai më kish folur për jetën e tij. Kish lindur e ish rritur në Saigon, në një familje të varfër. Në vitin 1954, në kohën e marrëveshjeve të Gjenevës, prindërit e kishin dërguar në Veri, për të vazhduar studimet e larta. Fati e solli që ai të vinte në Shqipëri ku kreuz studimet e larta. Lufta në Jugë e tanë në Veri e ndanë nga prindërit dhe nga qyteti i lindjes.

— Nam Bin është qytet i dëgjuar për prodhimin e tekstileve — vazhdoi të më tregojë shoku Shiu. — Përgjithësisht banorët e Nam Hasë janë edhe specialistë të mirë për luftë. Deçi më sot ata kanë rrëzuar 80 aeroplani amerikanë B. 52 dhe F. 105.

— Më flisni më shumë për këto gjëra, shoku Shiu — ju luta unë.

— Tani do të hamë mëngjezin, pastaj shokët e kësaj province do t'ju flasin me hollësi për të gjitha gjërat.

— Shkojmë, pra, — i thashë dhe u nisëm drejt kasolles sonë. Tingujt e muzikës vazhdonin të vinin gjer tek ne, ashtu si dhe më parë, të ëmbël e të lehtë.

Si hëngrëm mëngjezin, unë mbajta këto shënimë nga biseda që dëgjova nga sekretari i bashkimeve profesionale të provincës:

«Kasollja ku jemi ka qenë shkollë. Fëmijët, për t'i siguruar, i kemi çuar në zona më të thella e më të sigurta. Ju, shokë shqiptarë, kudo në vendin tonë shihni luftë dhe përpjekje për shtimin e prodhimit. Qyteti Nam Bin është qyteti më i madh i provincës sonë. Në këtë qytet francezët patën ndërtuar disa kombinate, ndër të cilët edhe një kombinat tekstili, që ka 13.000 punëtorë. Në vitin 1939 - 1940 këtu erdhën japonezët. 400.000 vetë vdiqën nga uria. Në disa fshatra s'mbeti njeri i gjallë. Po sot? Çdo vietnamez ka bukë, veshmbathje dhe armë. Ne jemi në gjendje ta vazhdojmë luftën 5,10,20 vjet. Deri tani kemi rrëzuar 80 aeroplanë amerikanë, duke përfshirë edhe fortesat B.82.

Provinca jonë është e zhvilluar nga pikëpamja bujqësore dhe industriale. Pas një muaji do të korrim orizin. Parashikojmë të marrim 50 kv. për hektar, por njëkohësisht përpinqemi për të zhvilluar bujqësinë intensive, për të marrë 80 kv. për ha. me dy korrije. Në qytetin Nam Bin, është zhvilluar industria tekstile, industria mekanike, ajo e elektrikut, e xhamit, e letrës etj. etj. Në

vitet 1966-1967 u ngriten 25 fabrika të reja dhe, megjithse jemi në luftë, plani i këtyre dy viteve u tejkalua 13% përi industrinë nacionale dhe 11% përi atë lokale. Qytetin dhe provincën e ka përfshirë një emulacion i paparë ndonjëherë. Qyteti Nam Bin është në fushë dhe jo më shumë se 20-30 km. larg flotës së shtatë amerikane. Pra qyteti bombardohet edhe nga ajri, edhe nga deti. Më 22 tetor Nam Bin u bombardua shumë rëndë. Amerikanët bombardojnë çdo gjë: ndërtesat, fabrikat, shkollat etj. Ata përpilen të shkatërrojnë komunikacionet tona, mirépo, qysh nga fillimi i bombardimeve, rrjeti i rrugëve të komunikacionit u shtua pesë herë në krahasim me vitin 1965. Kudo kemi organizuar detashmentet e rinisë, që luftojnë kundër amerikanëve dhe riparojnë udhët e bombarduara. Gjithshka është vënë në dispozicion të frontit. Maqinat, qerret, karrot e dorës, bile mijëra e mijëra biçikleta, plotësojnë nevojat e transportit. Edhe nëpër lumenj dhe nëpër ujërat e xhunglave kemi organizuar transportin me mjetë të thjeshta. Amerikanët qenkan llogaritarë shumë të këqinj. Ne vërtet s'kemi teknikë shumë të lartë për të ndërtuar ura të mëdha, por kemi eksperiencën popullore, që na ndihmon për të ndërtuar ura të nenujëshme me bambu. Më falni — vijoi shoku që po na fliste — kanë ardhur disa punëtorë për t'ju përshëndetur».

Ne kthyem kokën pas dhe pamë se po vinin ca punëtorë me fytyra të çelura e me vështrim të ngrohtë.

— Këta janë punëtorë të kombinatit të tekstileve — na tha sekretari. — Kombinati i tyre

është bombarduar 52 herë, por prodhimi i tij nuk  
është ndërprerë. Tani tezgahet po e endin pël-  
hurën nëpër fshatra. S'prish punë, apo jo? Çesh-  
tja është që të prodhojmë — dhe qeshi me gjithë  
shpirt. Qeshëm edhe ne, sepse në fjalët dhe  
në të qeshurit tij fshihej urtësia dhe besimi  
për të shkuar gjithnjë përpara.

— Tani këta punëtorë do t'ju japid një pro-  
gram me këngë vietnameze — na tha ai pas një  
heshtjeje të shkurtër — Shumica janë këngë të  
reja, të kompozuara kohët e fundit. Mua më pël-  
qejnë shumë, janë këngë revolucionare dhe të  
krijuara me frymëzim.

Pas pak jehuan tingujt e muzikës. Ishin po  
ata tinguj që dëgjova pak kohë më parë. Një  
vajzë zeshkane, me sy si bajame, filloj të këndo-  
jë. Ajo e mbante kokën pak lart. Krelat ja mbë-  
shtillnin fytyrën e këndshme, si në një kornizë.  
Ajo këndonte me një zë të bukur këngën që i  
kushtohej qytetit Nam Bin, heroizmit të masave,  
dëshmorëve të rënë, palmave, bambuve, lumenjve  
dhe plantacioneve të mbjella me oriz. Ndërsa vaj-  
za këndonte, muzika përhapej valë - valë nëpër  
kasolle dhe unë mendoja: — Ja trimat e vërtetë  
të tokës vietnameze! Këta këndojnë, kënaqin miqtë  
e tyre; pastaj do të shkojnë përsëri nëpër pyjet,  
ku janë vendosur repartet e kombinatit, për të  
vazhduar punën prodhonjëse. Dhe të gjitha këto  
ndodhin jo më shumë se 30-40 km. larg flotës  
së shtatë amerikane. Aeroplanët amerikanë mund  
të vijnë këtu brenda disa minutash, por ku pyet  
për gjëra të tillë ky popull? LUFTA, PUNA, KËN-  
GA! — ja ç'e karakterizon shpirtin e madh të

njeriut vietnamez. Sopata e ndryshkur e imperialismit amerikan godet kot në shtyllën e çelniktë me emrin Vietnam!

— Vazhdojmë bisedën, shokë shqiptarë? — na tha shoku vietnamez, kur mbaroi programi me këngë.

— Dakord.

— Edhe ju, shokë punëtorë, rrini e dëgjoni, pastaj mund të këndoni përsëri për miqtë dhe mund të bisedoni me ta.

Punëtorët pranuan me gjithë dëshirë.

Lufta kundër agresorëve amerikanë — e vazhdoi ai bisedën e ndërprerë — ka krijuar një gjendje shpirtrore të paparë ndonjëherë në të gjithë banorët e provincës sonë. Njerëzit janë bërë të papërtueshëm, gratë gëdhijinë në punë, të rinxjtë rrinë ditë e natë në fortifikatat kundërajrore; me pak fjalë, secili përpinqet t'i japë sa më shumë atdheut në këto momente të rëndësishme. Amerikanët pandehin se, duke na bombarduar, do të mundin ta paralizojnë jetën tonë, por ata s'i kanë bërë mirë llogaritë. Në vitin 1965, përpara se të fillonin bombardimet, ne kishim 6.700 mësues, kurse tani kemi mbi 10.000. Merreni me mend: ata «përhapësit e kulturës» as shkollat nuk mundën të na i paralizojnë dhe jo më prodhimin! Dhe pilotët amerikanë i ndjekin fëmijët dhe ndërtesat e shkollave, ashtu siç ndjek ujku i uritur qengjin.

— Siç ju thashë, deri më sot kemi rrëzuar 80 aeroplani amerikanë. Ky numër është edhe më i madh, por provinca jonë ka një fatkeqësi se ne jemi shumë afër detit dhe aeroplanët e qëlluar

bëjnë çmos për të mos rënë në tokë, por në det, që piloti ta shpëtojë lëkurën. Ne kemi parë me sytë tona sa e sa aeroplanë që kanë rënë në det, por qendra kërkon medoemos bishtin e tij. Për besë, shokë shqiptarë, njerëzit e provincës sonë, dinë të qëllojnë shumë mirë. Me pushkë fare të thjeshta, milicianët popullorë, kanë rrëzuar gjash-të aeroplanë amerikanë dhe kemi zënë shumë pilotë robër. Ata dridhen nga frika, kur bien në tokë. Njerëzit tanë kanë mësuar vetëm dy fjalë anglisht: «Mos luaj, duart lart!». Po ju tregoj një episod të vogël: në prill, kooperativistët e një kooperative malore rrëzuan një Fantam 105. Piloti ra, me parashutë në mal. Milicianët s'ju ndanë, por ai kishte qenë shumë i shkathët dhe u fsheh me marifet. Ç'na bën zotëria e tij? Me radio kërkon ndihmë. Dhe një natë veç kur erdhi një elikopter. Milicianët popullorë panë se zbritën me parashutë gjashtë vetë. Milicianët e qëlluan eli-kopterin dhe i vranë parashutistët. Njëri kish qenë mjek. Pas katër ditësh, ata zunë rob edhe pilotin e fshehur. Me këtë episod, desha të tregoj për heroizmat e milicisë popullore, forca e së cilës është shumë e madhe. Ajo bashkëpunon ngushtë me ushtrinë. Kur plagosen ushtarë, të rinjtë milicianë i zëvendësojnë menjëherë. Sot dëshira më e madhe e të rinjve është të pranohen në radhët e ushtrisë. Ata janë në gjendje të përdorin llojet më kryesore të armëve, dinë të çmontojnë bombat me plasje të vonshme etj. Milicianët punëtorë të centralit elektrik kanë çmontuar kushti sa bomba të vështira, sepse amerikanët po bëjnë çmos për të na shkatërruar centralin elek-

trik. Ne po e mbrojmë me vëtmohim atë, por edhe në qoftë se do ta prishin, ne kemi shumë mënyra të tjera për të patur korrent elektrik.

Aviatorët amerikanë përpiken të tregohen shumë të djallëzuar. Për shembull vijnë njëqind aeroplanë. Një pjesë qëndron shumë lart, për të qëlluar artilerinë tonë kundërarjore, një pjesë zbret më ulët dhe bombardon shtëpitë, qendrat e punës dhe fshatrat, ca të tjerë futen befasisht, për të krijuar konfuzion në mbrojtjen tonë. Mirëpo dinakëria e tyre s'pi ujë përpara mënçurisë dhe guximit të njerëzve tanë. Aeroplanët në lartësi të madhe ne i qëllojmë me raketa, ata që janë më ulët i godasim me artileri, kurse aeroplanët tinzarë i godasim me mitroloza të rëndë, të lehtë dhe me pushkë. Amerikanët i pushton kështu një konfuzion i tmerrshëm, shthuren dhe marrin brigjet e lumenjve për të shpëtuar. Por edhe këtu i ndjek pushka dhe mitrozi i milicisë populllore.

— Ja, filluan bombardimet — tha një shok tjetër vietnamez. Ne mbajmë vesh. Dëgjojmë një gjëmë të largët, që i shëmbëllen gjëmës së një bubullime në pranverë.

— Ku bombradojnë?

— Në Nam Bin.

Gjëma vjen gjithnjë duke u shtuar dhe toka fillon e dridhet pak, tamam sikur bie tërmet i lehtë. Ne u ngritëm dhe dolëm jashtë. Qielli i kaltër dhe i pafund shkëlqente. Pas disa minutash ne pamë një grup aeroplanësh, që fluturuan mbi kokat tona. U përpoqa t'i numëroj dhe arrita deri në numrin njëzet e shtatë, por nuk munda

më, se atani mbuloi drita e fortë dhe gjallëronjëse e diellit që më verbonte sytë.

— Nga shkojnë tani ata?

— Nëpër provinca të tjera, ndoshta edhe në Hanoi.

U kthyem përsëri në kasolle dhe vazhduam bisedën. Pastaj vajza punëtore na këndoi përsëri. Një nga këngët, që na preku më shumë, ishte ajo kushtuar fëmijëve të vrarë në rrugën Hau Fao të qytetit Nam Bin. Fytyra e vajzës ndërrohej papushim, duke shprehur në të njëjtën kohë urrejtjen e madhe kundër vrassësve amerikanë, hakmarrjen dhe optimizmin në fitore. Çdo lëvizje e saj më dukej sikur shpaloste një fuqi të madhe që të rrëmbente.

Kur po e duartrokisnim, ajo erdhi te ne dhe na dhuroi pak mëndafsh të prodhuar nga kombinati i tekstileve dhe nga një unazë të bërë me materialin e aeroplanit të 76-shtë amerikan, të rrëzuar në provincën Nam Ha.

— Kur gratë tuaja të veshin mëndafshin tonë, — na tha ajo me një zë që i dridhej nga emociioni — kujtoni vendin tonë, kur të vini këto una-za, kujtoni heroizmin e banorëve të provincës sonë... .

Gati sa nuk qava. Ato ishin dhurata shumë të shtrenjta. Kurrë nuk do ta harroj atë çast, dhe jam i bindur se fytyra e vajzës punëtore Bish Lien dhe gjithë qenja e saj plot jetë e bukuri nuk do të më shqiten nga kujtesa... »

24,25 tetor:

U bënë dy ditë që ndodhemi në provincën Than Hua, të pjesës qendrore të RD të Vietnamit. Gjatë këtyre dy ditëve kam grumbulluar

shumë të dhëna, që më kanë lënë mbresa aq të thella sa nuk e di a do të jem në gjendje t'ua transmetoj me besnikëri lexuesve të mi.

Sidoqoftë, lexuesit duhet të më falin, në qoftë se nuk do t'ja arrij qëllimit, sepse këtu, ashtu si në çdo provincë tjetër të Vietnamit, has të tilla pamje, bisedoj me të tillë njerëz, dëgjoj e shoh të tilla gjëra të madhërishme, heroike dhe fisnike, sa jam i bindur se cilido që të ishte në vendin tim do ta kishte pisk t'i shprehte këto me tërë forcën dhë poezinë e tyre.

Pikësëpari po përshkruaj ambientin ku ndodhemi dhe disa karakteristika të përgjithshme për këtë provincë. Për të banuar na kanë shpënë në një kasolle të bukur prej bambuje, në mes të një pylli të dendur prej drurësh kafeje. Kasollja jonë është në një lugine të ngushtë e të gjelbër, prej nga përhapet një aromë e këndshme, kundërmognjëse. Rreth e rrotull ka kodra të mbjella me kafe. Ato ngjajnë si ca piramida gjigante, të veshura me rroba të gjelbra. Kur i sheh që poshtë nga lugina, të duken si ishuj në oqean.

Rrugët që të ngjisnin nëpër këto kodra janë të ngushta, bari në këto anë është i dendur, i imët e i butë si mëndafsh. Ngado që të hedhësh sytë, pamja është pothuajse njëlloj: kudo ka kodra të gjelbra.

Ajri këtu është më i freskët, hijet janë të dendura, sepse dielli e ka të vështirë të përshkojë nëpër pemët e panumërtë tërë gjethë dhe që janë mpleksur greth me njëra-tjetër. Shkurt: xhungël tipike. Dhe e gjithë kjo është plantacion kafeje. Nuk kam parë kurrrë në jetën time një plantacion

kaq tē madh me kafe. Bile as qē e dija se kafeja e paskérka drurin tamam si drunjtē e ullinje qē rriten nē anët toni.

Shokét vietnamezë na shpunë nëpër kodra, pér tē parë edhe më mirë plantacionin. Dhe sa më thellë qē hyje, aq më i dendur bëhej pylli. Këtu rriteshin tri lloj drurësh kafeje: arabika, robuse dhe shari. Arabika jepte më shumë prodhim dhe cilësia e kafesë ish më e mirë. Çdo pemë jepte 50-60 kg. kafe tē njomë, por kur kafeja thahej, kjo peshë zbriste nē dhjetë kg. Pema, kur mbushte moshën 15-20-vjeçare, arrinte kulmin e rendimentit, pastaj fillontemplakja dhe rendimenti vinte duke rënë. Atëhere, specialistët e prisnin trungun e pemës dhe pas disa vjetësh rriteshin filizat e rinj. Kështu pema fillonte përsëri nga prodhimi.

Dikur ky plantacion na qenkish administruar nga francezët, por nē atë kohë ai kish qenë një plantacion i vogël rrëth 100 hektarësh, kurse tanë është rritur shumë dhe zë një sipërfaqe prej më shumë se 2000 hektarësh.

Ndërsa ne ecim nëpër këtë pyll tē madh me kafe, qyteti Nam Ha, që ndodhet jo shumë larg nesh, po bombardohet nga aviacioni amerikan. Zhurma e bombave arrin tek ne si një jehonë mytëse, e vrazhdë dhe e ndotur. Kjo zhurmë neve na i tërheq vëmendjen, kurse shokëve vietnamezë duket sikur s'para u bën përshtypje. Ata vazhdojnë bisedën e tyre po me atë ton, duke folur me zjarr pér rritjen e prodhimit dhe pér planet e mëdha tē së ardhmes.

Edhe këtë plantacion, amerikanët e kishin

bombarduar katër herë. Ata kishin djegur kasolle, kishin vrarë lopë e shqerra dhe kishin dëmtuar disa drunj kafeje. Ja pra se deri ku arrin poshtërsia e tyre!

Kur u kthyem në kasollet tona, gjetëm shumë punëtorë që kishin ardhur për të na përshëndetur. Ne u takuam me ta si me vëllezërit tanë.

— Rroftë PPSH dhe shoku Enver Hoxha! — thirri një punëtor me trup të bëshëm, që kish një zë të fortë.

— Munam, munam, munam! (që do të thotë rroftë, rroftë, rroftë!) u përgjegjën të gjithë në kor të përbashkët.

Shumica janë femra. 200 të rindë punëtorë të këtij plantacioni kishin vajtur vullnetarisht në ushtri dhe vendin e tyre e kishin zënë gratë, nénat dhe motrat e tyre.

Kjo provincë nga pikëpamja strategjike është një nga prapavijat e avancuara të Vietnamit të Jugut dhe të Laosit. Ajo ka 1 milion e 950.000 banorë, të cilët jetojnë në njëzet e një distrikte. Njerëzit e kësaj province janë punëtorë të zotët dhe trima, që të marrin gjak në vetull. Edhe tanë ata po bëjnë një luftë legjendare kundër agresorëve amerikanë dhe ja kanë ngulur thikën në koskë imperializmit amerikan. Kjo provincë ka edhe një pozicion të favorshëm gjeografik. Ajo pjesërisht përbëhet nga zona të tëra bregdetare, fushore, kodrinore dhe malore. Amerikanët e kanë goditur me qindra e qindra herë nga ajri dhe nga deti këtë provincë, dhe kanë hedhur mesatarisht tri bomba për çdo frysme. Por banorëve trima të Than Huasë s'jau bën tër veshi. Ata luftojnë me

guxim dhe prodhojnë. Sivjet shumë zona të kësaj province, në sajë të kohës së mirë, të punës së palodhur, arritën të marrin tri korrje në vit me një prodhim mesatar prej 42 kv. për hektar dhe zunë 250.000 tonelata peshk, megjithëse kryqëzo-rët e flotës së shtatë amerikane ishin «zotuar» të mos lejonin asnje barkë peshkatarësh të futej në oqean.

I shkëlqyer paraqitej edhe prodhimi industrial. Mendoni: vetëm industria mekanike në vitin 1966 ish rritur tetëdhjetë e ca përqind në krahasim me vitin 1965. Gjë me të vërtetë e habitshme.

Amerikanët pandehin se shkatërruan çdo gjë, kurse rritja e zhvillimit të industrisë e të bujqësisë dhe ngritja e fabrikave të reja shtohen nga viti në vit. A nuk kanë të drejtë të tërbohen strategët amerikanë nga tërë këto të papritura, nga tërë kjo tallje që po u bën atyre populli vietnamez? Vërtet, bela e madhe për Shëtëpinë e Bardhë! Dhe jo vetëm kaq. Gjaku amerikan po derdhet rrëke në truallin vietnamez. Deri atë ditë vetëm kjo provincë kish rrëzuar 246 aeroplanë amerikanë, përvëç 28 anijeve luftarake dhe një kryqëzori të madh me 1200 ushtarë brenda, që ishte fundosur. Kjo është pra provinca Than Hua! Atje jetojnë, punojnë dhe luftojnë pjesëtarët e famshëm të togës së pleqve, të cilët me karabina të thjeshta rrokullisën më 17 tetor aeroplanin amerikan F. 105 dhe e shpunë numrin e aeroplanëve të rrëzuar në RD të Vietnamit në 2400. Kjo është provinca e famshme, ku toga e grave të milicisë popullore rrëzoi në Veri aeroplanin e parë amerikan.

Ne kemi shumë dëshirë ta vizitojmë qytetin legjendar Nam Ha, ku ndodhet edhe ura e famshme Hamrong. Për një kohë të gjatë amerikanët po mundohen ta shkatërrojnë këtë urë, por ajo është bërë e paprekshme nga heroizmi i ushtarëve dhe i milicisë popullore.

— Për të vajtur atje, është shumë rrezik, — na thanë shokët vietnamezë. — Qyteti dhe ura Hamrong bombardohen ditë e natë me egërsinë më të madhe.

— S'prish punë, — u thamë ne. — Është mëkata të vish deri këtu dhe të mos shohësh këtë urë legjendare, ku qenkan rrëzuar 99 aeroplanë amerikanë.

— Mirë, do ta diskutojmë propozimin tuaj, — na u përgjegj sekretari i dytë i komitetit të partisë pér provincën.

Shoku Shiu, përkthyesi ynë, afrohet dhe më tregon.

— Vjet, — më thotë ai, duke picërruar sytë e tij të vegjël, — Maknamara vizitoi Vietnamin e Jugut dhe shkoi pér inspektim në disa aeroplanchajtëse të flotës së shtatë. Ish shumë i zemëruar që ura Hamrong vazhdonte të shërbente si arter që lidh Jugun me Veriun. «Ura Hamrong duhet të asgjësohet me çdo kusht, — u bërtiti ai oficerëve, aviatorëve dhe marinareve. — Goditeni edhe me raketat e kryqëzorëve, — dhe iku tërë inat. Këto që ju them, o shok, janë të vërteta, këto i kanë pohuar vetë aviatorët amerikanë të zënë rob.

— Po a do ta vizitojmë këtë urë apo jo?

— Shokët e provinceës po e studjojnë kërke-

sën tuaj. Unë besoj se do ta viziton, sepse kjo  
është një kërkesë revolucionare.

— Faleminderit, shoku Shiu.

— Aviatorët amerikanë frikësohen shumë,  
kur marrin urdhër për të bombarduar urën Ham-  
rong. Dhe nga frika e godasin urën me raketa,  
duke i lëshuar ato nga një largësi prej dhjetë-dy-  
mbëdhjetë kilometrash, pastaj bombardojnë edhe  
vetë në pikatë

— Ç'urë e lavdishme!

— Ka një legjendë për të. A ke qejf të ta  
tregoj?

— Oh, si jo.

— Mirë pra, dëgjoni: ju keni vënë re se ma-  
let e Than Huasë kanë formën e vezëve të mëdha.  
Të tilla male ka edhe rrëth e rrotull urës. Këto  
male, legjenda i ka quajtur «Dragoi me sy dia-  
manti». Thuhet se mijëra vjet më parë një dragoi,  
tek po kapercante lumin Ma (në vietnamisht Ma  
do të thotë «Kali revan»), njëri sy i ra në bregun  
tjetër. Dhe me të vërtetë, në vendin ku fillon ura  
njëri nga malet ka tamam formën e kokës së dra-  
goit, tjetri atë të mjekrës, kurse nga larg, në bre-  
gun tjetër, duket mali që mori emërin «Syri i  
dragoit». Kjo është legjenda.

— Interesante, — pëshpërita unë. — Kuptimi  
është i thellë. Syri prej diamanti në anën tje-  
tër të lumit mendoj se simbolizon nevojën e  
domosdoshme për t'u lidhur me viset e tjera përtëj  
lumit, që ndoshta kanë qënë më të pasura.

— Mbështet, — pëshpëriti ai, duke mbledhur  
supet dhe shtoi: — Tani koka, mjekra dhe syri i

dragoit pérhapin një zjarr tē tmerrshém kundér amerikanëve.

— A dihet me saktësi kur éshtë ndërtuar ura Hamrong?

— Dihet fare mirë. Ajo éshtë ndërtuar në kohën e okupacionit francez. Atëherë ajo ish më e vogël dhe më e ngushtë nga ç'është sot. Kur erdhën japonezët në Vietnam, kjo urë u bë polygon. Gjatë luftës së dytë botërore aviacioni amerikan e bombardoi shumë herë këtë urë. Ushtarët japonezë kishin aq frikë tē qëndronin në mbrojtje të urës, sa që oficerët i mbanin ushtarët tē lidhur me litar, sepse iknin nga frika. Partizanët tanë e minuan dhe e shkatërruan urën, por pas çlirimt ajo u ndërtua përsëri me ndihmën e shokëve kinezë dhe u bë më e madhe, më e gjerë dhe më e bukur. Në mes kalon hekurudha, anash kalojnë maqinat, biçikletat dhe këmbësorët.

— Ç'paskan hequr ushtarët japonezë tē lidhur me litarë!

— Komedii! — tha Shiu duke qeshur — Kur se ushtarët tanë, milicianët popullorë mburren që u ka takuar fati tē ruajnë urën Hamrong. Një herë u rastisi tē luftojnë pér mbrojtjen e urës edhe gjashtë vajzave. Ato ishin fare tē reja dhe pa ndonjë përvojë luftarake. Ushtarët tanë u habitën me trimërinë e këtyre vajzave. Me dhjetëra aeroplana amerikanë po bombardonin urën kurse vajzat shtinin me furi tē madhe. Vajza tetëmbëdhjetëvjeçare Fong Ding, qëllonte vazhdimisht me mitrolozin e saj. Tyta e mitrolozit ju skuq flakë, por ajo s'kishte nge ta shihte këtë gjë. Më në fund tyta e mitrolozit u këput fare. Fong Dingu filloi

të qajë nga dëshpërimi. Duart ju dogjën. Ajo deshte të shkonte në llogoret e ushtarëve, por e mbajtën shoqet, se rrëth e rrotull binin qindra bomba e raketa.

— Shpëtoi? —

— Po, shpëtoi. Ajo vazhdon të jetë punëtore dhe anëtarë e milicisë popullore. Ka shumë shembulla të tilla...

Po atë natë shkuam për të parë urën. Unë ndjeja një kënaqësi të madhe, kur sillja ndërmend tërë ato ngjarje madhështore që kisha dëgjuar për urën me emërin poetik: Hamrong.

Mesi i natës kishte kohë që kishte kaluar. Maqinat tonë ecin me shpejtësi të jashtëzakonshme. Ajri i freskët, hijet e natës, që luhatin qielli me plot yje vezullonjëse, kënaqësia që ndjenim, të gjitha këto, më krijonin një farë shqetësimi dhe padurimi për të mbëritur sa më parë tek ura.

Dhe s'shkoi shumë kohë kur përpara nesh u duk ura Hamrong, e thjeshtë dhe krenare. S'di përsë m'u duk sikur kish veshur një mantel prej çelniku. Fytyra e saj, supet e saj, krahët e saj të pa-lëvizshëm fshihnin diçka si të mbinatyrrshme. Këmbët e saj vigane shtriheshin në luginën e thellë të lumenit, që rriddhë duke përhapur një zhurmë të mbytur e monotone. — Kjo është një nga urat e jetës vietnameze — mendoja me vete, tek e vështroja me një dashuri të çuditshme. Dhe ajo, e madhe, me atë veshjen e bukur prej çelniku, më dukej sikur kishte në vetëvete një menguri, një trimëri dhe një fuqi aq të madhe, sa me bindjen më të plotë thashë: Ti je e përjetshme, urë e dashur!...

Po largoheshim, por unë doja të vështrojë akoma.

Në mugëtirën e natës rrëth e rrötull saj, si ca karakolle gjigante, dukeshin malet e dragoit, për të cilat më kish folur shoku Shiu.

Hypëm nëpër maqina dhe pas pak mbërritëm në një breg shumë të lartë. Duke ecur në këmbë nëpër këtë breg guror na doli përpara një njeri me trup të madh, i cili na shtërgoi dorën një e nga një. Vetëm kur e kisha fare pranë, pashë se ai ishte ushtarak. Kishte një fytyrë të këndshme. Flokët e tij të ashpër e të dendur dhe të ndarë anash i jepnin një pamje edhe më të bukur.

— Mirë se ardhët, mirë se ardhët, — na tha ai me gjithë zemër. — Ushtarët po ju presin me gjëzimin më të madh.

Pa u afruar mirë te llogoret shpërthyen duartrokutje të forta. Bregorja dhe lugina e gjerë, që shtrihej gjer poshtë nesh, morën një bukuri të rrallë. Përfytyroni një llogore të zakonshme, ku është vendosur një bateri kundërajrore, përfytroni topa me gryka të gjata, që duket sikur po e përpijnë qiellin e heshtur.

— Ushtarët e kësaj baterie, — na spjegoi shoku Bai, që na priti në bregore, — kanë trenguar heroizma kolektive dhe individuale. Një ushtar u plagos rëndë, këmba ju këput fare, por ai s'donte të largohej nga pozicioni. Një tjetri ju këput krahu, por as ai nuk donte ta linte vendin e tij të luftës.

— Këto heroizma na mbushin zemrën plot gjëzim dhe ne ju urojmë fitore të reja, — u tha ushtarëve kryetari i delegacionit tonë.

— Ardhja juaj këtu, — u përgjegj njëri nga ushtarët, — është fryshtësim i madh për ne. Ne do ta ruajmë urën të paprekshme deri sa të cilohet i gjithë Vietnamit.

— Deri tani, — vijoi shoku Bai, — artilierët tanë kanë rrëzuar 99 aeroplani amerikanë, duke përfshirë edhe një aeroplane të madh C-130 me 12 pilotë dhe kemi zhvilluar mbi 300 beteja me avionin amerikan. Me 3 prill të vitit 1965 aeroplani Amerikanë bombarduan tri herë dhe në çdo bombardim morën pjesë nga njëqind aeroplani. Dëgjoheshin vetëm zhurma e aeroplani, bombave e raketave, dhe të shtenat e artillerisë sonë. Qielli u nxi i terti. Atë ditë ne rrëzuam 17 aeroplani. Kjo e tërboi komandën amerikane, prandaj të nesërmen dërgoi edhe më shumë aeroplani për të shkatërruar urën Hamrong. Por ura mbeti e paprekshme, dhe atë ditë ne rrëzuam edhe 47 aeroplani të tjera. Veç të shihnit si u mbush atëhere lugina me avionë amerikanë të bërë copë-copë!

Kryetari i delegacionit tonë u foli me emociion këtyre trimave dhe i përgëzoi edhe një herë duke u uruar fitore të reja edhe më të shkëlqyera.

Hijet e natës po zhdukeshin dalëngadalë. Nga lindja kishte filluar të ndriste një si brez i bardhë. Majat e maleve po dukeshin më qartë nga rrezet e para të agimit. Në këtë kohë ne shkuam edhe në një bateri tjetër. Atje biseduam përzemërsisht me ushtarët e topit Nr.3, shumica e të cilëve kohët e fundit ishin pranuar në parti, dhe pastaj u nisëm për në hotelin tonë «Ndërkombëtar»

siç e cilësoi me shaka një nga shokët vietnamezë që na shoqëronin.

Kur mbërritëm në kasolle, shkrepën rrezet e para të diellit dhe gjithë natyra mori një pamje të mrekullueshme.

Ulem në një karrige pranë kasolles, dhe shkruaj. Ndërkojë dëgjoj se në drejtëm të qytetit Nam Ha filluan përsëri bombardimet. Në këtë kohë kujtova ushtarët vietnamezë pranë urës Hamrong dhe zërin burrëror të artilierit, që na tha: «Ne do ta ruajmë urën të paprekshme deri sa të çlirohet i gjithë Vietnamit.»

Pas pak zhurma e aeroplanëve filloj të bëhej gjithnjë e më e fortë. Aeroplanët po afroheshin drejt nesh. Pra po vinin këtej nga ne. Befas pëlciti një gjëmë e llahtarshme. Dhe ç'të shihje? Aeroplani kish hedhur një raketë mu në mes të orizores, ndërsa fshatarët edhe pas pëlcitjes vazhduan të punonin si më parë.

— Përse e hodhi aty raketën? — pyeta një shok vietnamez.

— Ndoshta për të goditur fshatarët që po punonin, ose për të lehtësuar peshën e tij, sepse, kushedi, e ka patur pisk. Mundet që të ketë qenë edhe aeroplan i qëlluar.

Kur vajti ora tetë, ne u takuam me heroinën Trin Thin Tin. Ajo ishte brigadierja e brigadës që merrej me riparimin e rrugëve të komunikacionit.

Ishte një grua e shëndoshë, me shpatulla të gjera, me mollëzat e faqeve pak të dala dhe me një gërshtet flokësh korb të zi të lidhur bukur dhe të hedhur prapa.

Pasi u përshëndet me ne, ajo filloi të tregojë thjesht dhe bukur:

«Situata e luftës krijoj brigadën tonë, ku marrin pjesë gratë që zëvendësuan burrat, të cilët janë në front. Detyra jonë është të sigurojmë trafikun prej 21 km. gjatësi nga ura Hamrong te ura Leng. Megjithëse amerikanët e bombardojnë egërsisht këtë pjesë të rrugës, ne deri tani kemi bërë çmos dhe kemi arritur ta mbajmë në gjendje të mirë. Përpara ca kohësh udhëheqja e provincës na ngarkoi të ndërtojmë një urë të re prej 85 metrash të gjatë dhe me gjashtë këmbë, lartësia e të cilave të ishte 15 metra. Mirëpo ne nuk dinim të përdornim çekicin pneumatik, sepse s'kishim teknikë dhe arësim të lartë. Por vullneti bën mrekullira. Dy nga shoqet e brigadës sonë kishin qenë studente në një teknikum ndërtimi. Ato u muarën vetëm me këtë punë dhe ja dolën mbanë. U detyruam të mësonim edhe si karpentiere, por pastaj na lindi problemi tjetër i vësh-tirë: si të transportonim hekurat dopio, që peshonin 12 kv. secili dhe që ishin të gjatë 85 metra. Më në fund bëmë argonelo për t'i tërhequr. Kështu, me përpjekje të mëdha, duke punuar shpeshherë nën rrebeschin e bombave amerikane, ne e mbaruam urën dhjetë ditë përpara afatit. Ajo është në gjendje të mbajë maqina me një peshë deri në 25 ton. Siç ju thashë, ne punojmë edhe atëhere kur mbi kokat tona fluturojnë dhe bombardojnë aeroplanët amerikanë. Pra jemi të detyruara edhe të punojmë edhe të hapim llogore për të luftuar kundër tyre. Një natë amerikanët bombarduan shumë rëndë rrugën afër urës Ham-

rong. Ne u futëm në llogore dhe filluam të gjuaj-  
më me pushkët tona. Bombat dhe raketat pëlcis-  
nin me zhurmë rrëth e rrötull nesh, dheu na  
mbuloi, disa shoqe u plagosën, por fill pas bom-  
bardimit ne ndreqëm çdo pjesë të bombarduar të  
rrugës. Brigada jonë ka 154 gra dhe vajza. Atje  
gjithmonë dëgjohet kënga. Shoqet tona thonë se  
kënga e mund britmën e keqe të bombave dhe të  
raketave amerikane. Ne kemi edhe një grup ar-  
tistik që i kompozon këngët tona...

Bisedën na e ndërprenë bombardimet e avia-  
cionit amerikan. Vura re se heroina befas mori  
një pamje të rreptë. Të dukej sikur gjithë tiparet  
e fytyrës së saj diç pëshpëritnin.

— Mos po bombardojnë urën Hamrong? —  
e pyeti dikush.

— Po, — tha ajo me bindje të plotë. — Atë  
dhe një urë tjetër pranë saj.

Neve na erdhë keq, që kjo trimëreshë s'ish  
tani pranë heroinave të tjera të brigadës.

— S'ka gjë, — vijoi ajo, duke i dhënë fyty-  
rës një pamje të qetë, dhe buzëqeshi. — Le të  
bombardojnë, ne jemi në gjendje ta rregullojmë  
përsëri në një kohë të shkurtër.

Dhe fliste ajo po me atë tonin e saj që të  
rrëmbente, kurse unë vështroja buzëqeshjen e saj  
hirplate. Këtë buzëqeshje e kam vënë re tek çdo  
vietnamez me të cilin jam takuar e kam biseduar.  
Ky është një tipar i njeriut vietnamez, është  
pasqyrë e gjallë e vrullit të jetës së gjëzuar, e  
vrullit që të çon gjithnjë përpara, drejt jetës së  
lumtur...

\* \* \*

Ditët e fundit të largimit nga Vietnam i kaluan në Hanoi. Ato ishin ditë të stuhishme. Amerikanët ishin hedhur me tërbimin më të madh kundër Hanoit. Aeroplanët e tyre, grupe-grupe, vinin dhe bombardonin ditë e natë fabrikat, shtepitë, centralet elektrike dhe udhët.

Më 24 dhe 25 tetor artileria dhe milicia popullore kishin rrëzuar 15 aeroplanë, kurse më 26 u rrëzuan pesë aeroplanë të tjera. Toka dridhej dhe qelli oshëtinte. Atë ditë ne ishim futur në strehim, por shpeshherë delnim prej tij, sepse dëgjonim britma të gjëzuarja njerëzish:

— U rrëzua, u rrëzua!

Dhe ç'të shihje? Shumë banorë të Hanoit, megjithëse bombardimi vazhdonte, vraponin drejt aeroplanit të rrëzuar. Sa çaste të paharrueshme! Ata kishin marrë pjesë në kapjen e pilotit amerikan, u tregonin të tjerve me fjalë e me gjeste se si piloti amerikan kish ngritur duart përpjetë, si qante dhe se si u lutej vietnamezëve t'ja falnin jetën...

### 27. tetor:

Përsëri bombardim i fortë mbi Hanoi. Një nga objektet e bombardimit ishte edhe termocentrali që ndodhej jo shumë larg ndërtësës sonë. Atje u rrëzua një aeroplan amerikan. Ne shfagëm dëshirën për ta parë. Megjithëse rreziku ish i madh, shokët vietnamezë na e plotësuan edhe këtë kërkësë.

Në termocentral punëtorët ishin shumë të qetë, sikur këtu të mos kish ndodhur asgjë.

Aeroplani amerikan A-4 për çudi kishte rënë mu pranë murit të ndërtuesës së termocentralit dhe ishtë bërë copë-copë në togun e mbeturinave të qymyrgurit. «Ja cili është fundi i piratëve amerikanë» mendoja me vete tek mbaja në dorë një pjesë të metalit të aeroplanit. Populli vietnamez e detyroi atë të ngordhët në qymyr. Kështu do të ngordhni ngahera, vrasës dhe përbindsha amerikanë! Mos u gënjejë mendja, plaga juaj është e pashërueshme!.

U larguam nga termocentrali. Atë ditë kishim një program të gjerë takimesh dhe vizitash dhe duhej preqatitur fjalimi që do të mbanim në një miting të madh me punëtorët e kryeqytetit. Programi u realizua. Ne takoheshim e njiheshim me shokët vietnamezë edhe kur vazhdon-ten bombardimi i avacionit amerikan.

Mitingu u bë. Kryetari delegacionit tonë u transmetoi punëtorëve të Hanoit ndjenjat më të zjarrta dhe solidaritetin luftarak të klasës sonë punëtore dhe të mbarë popullit tonë. Përfaqësu- esit e punëtorëve vietnamezë, me një emocion të papërshkrueshëm, ju lutën delegacionit tonë t'i transmetonte popullit tonë, PPSH dhe shokut Enver Hoxha falënderimet e tyre më të singerta dhe sigurinë e plotë se populli vietnamez do ta çojë deri në fitoren e plotë luftën e tij kundër agresorëve amerikanë, deri sa të çlirohet gjithë Jugu dhe të shporret nga toka vietnameze edhe ushtari i fundit amerikan.

Pastaj u dha një program i madh artistik.

Nuk do t'i harroj kurrë ato fytyra të qeshura dhe plot jetë të pjesëmarrësve në meting dhe të artistëve të mrekullueshëm, që interpretonin dhe këndonin me një bukuri të rrallë. Mua s'më besohej se shfaqja po jepej në Hanoi, por më dukej sikur ishin në Tiranë dhe po shihnim një grup artistik vietnamez. E tillë është gjendja shpirtërore e vietnamezëve: e gëzuar, si një lule e re, e bukur, që lulëzon e rritet nën rrezet e ngrohta të diellit...

O popull vietnamez, s'gjej dot fjalët më të bukura për të të krahasuar. Ti e pështyn në fytyrë imperializmin amerikan dhe ty çdo gjë të ka hije, se ti je zot i jetës dhe i së ardhmes së mrekullueshme, ti je plot besim në veten tënde dhe i thua gjithë botës: «Ngadhnjej! Bjerini edhe ju bishës amerikane, që ta djegim me katran dhe ta varrosim përfundimisht! . . .»

O Vietnam, Vietnam, krenaria jonë, poema më e madhe e kohës sonë! . . .

46438

**BLUETKA E SHIET**  
**GJIROKASTRE**